



**TEB**

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

# 2015 Raporti vjetor



TEB SH. A, Kosovë

## Zgjerohmë botën tuaj

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi ta rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Shërbimi më i mirë për klientët individualë dhe bizneset. Kjo e shtyn TEB Sh.A. përpara. Thelbi i shërbimit dhe misionit tonë është etika afariste. Prandaj, marrëdhënia e besimit që kemi ndërtuar me kohë është sot pasuria jonë numër një.

## Vlerat tona

Të ndershëm dhe të besueshëm

Drejtues, pararendës dhe inovativë

Të orientuar kah klienti dhe me fokus të fuqishëm tek cilësia e lartë

Plot respekt për shoqërinë, të drejtat njerëzore dhe mjedisin

Transparentë

## Faqet

|           |                                                                                              |    |
|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>1.</b> | <b>Mbi TEB SH. A.</b>                                                                        |    |
| 1.1.      | Profili i korporatës                                                                         | 6  |
| 1.2.      | Misioni, vizioni dhe strategjia jonë                                                         | 9  |
| 1.3.      | Vlerat tona themelore                                                                        | 10 |
| 1.4.      | Struktura aksionare                                                                          | 11 |
| <b>2.</b> | <b>Panorama e 2015-ës dhe perspektiva e 2016-ës</b>                                          |    |
| 2.1.      | Pasqyra makroekonomike                                                                       | 13 |
| 2.2.      | Nga Kryetari                                                                                 | 14 |
| 3.3.      | Nga Drejtori Ekzekutiv                                                                       | 16 |
| <b>3.</b> | <b>TEB SH. A. gjatë 2015-ës</b>                                                              |    |
| 3.1.      | 2015-a me një vështrim                                                                       | 19 |
| 3.2.      | TEB SH. A. në shifra                                                                         | 22 |
| 3.3.      | Indikatorët financiarë kyç                                                                   | 23 |
| <b>4.</b> | <b>Njësitë e biznesit</b>                                                                    |    |
| 4.1.      | Shërbimet bankare për individë                                                               | 26 |
| 4.2.      | Biznesi i kartelave                                                                          | 28 |
| 4.3.      | Shërbimet bankare për NVM-të                                                                 | 30 |
| 4.4.      | Shërbimet bankare komerciale dhe për korporata                                               | 31 |
| 4.5.      | Financat tregtare                                                                            | 32 |
| 4.6.      | Menaxhimi i parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave                                        | 33 |
| 4.7.      | Thesari dhe MPD-ja                                                                           | 34 |
| 4.8.      | Burimet njerëzore                                                                            | 35 |
| 4.9.      | Organizimi dhe zhvillimi i proceseve                                                         | 37 |
| 4.10.     | Teknologjia informative                                                                      | 38 |
| 4.11.     | Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale                                  | 39 |
| <b>5.</b> | <b>Menaxhmenti/Qeverisja korporative</b>                                                     |    |
| 5.1.      | Struktura organizative e TEB Sh. A.                                                          | 42 |
| 5.2.      | Bordi i Drejtorëve                                                                           | 43 |
| 5.3.      | Komitetet                                                                                    | 47 |
| 5.4.      | Auditimi i Brendshëm                                                                         | 50 |
| 5.5.      | Menaxhimi i Rrezikut dhe Rreziku Operacional<br>e Vazhdimësia e Biznesit                     | 50 |
| 5.6.      | Pajtueshmëria dhe Kontrolli i Brendshëm                                                      | 53 |
| <b>6.</b> | <b>Raporti i Auditorit</b>                                                                   |    |
| 6.1.      | Raporti i Pavarur i Auditimit i datës 31 dhjetor 2015<br>dhe Shënimet në Pasqyrat Financiare | 56 |

## TEB Sh. A Raporti vjetor 2015

**Data e raportit:** 01.01.2015 — 31.12.2015

**Adresa:** Agim Ramadani Street, Nr. 15, 10000 Prishtina

**Telefoni:** +381 (0) 38 230 123

**Fax:** +381 (0) 38 224 699

**Email:** [info@teb-kos.com](mailto:info@teb-kos.com)

**Web:** [www.teb-kos.com](http://www.teb-kos.com)

Mbi TEB SH. A

## 1.1. Profili i korporatës

### Zgjerohet botën tuaj...

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi ta rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Pas tetë vitesh të suksesshme në Kosovë, TEB Sh.A. (TEB) ka bërë emër në sektorin bankar, duke fituar reputacion bukur të merituar për shërbim të shkëlqyer. Gjithmonë e sistematikisht kemi çelur shtigje të reja për të përmbushur nevojat e individëve dhe bizneseve për shërbime bankare e financim, duke lansuar shumë produkte e shërbime për 'herë të parë' në tregun e Kosovës.

Sot, bota ndryshon me shpejtësi, por TEB-i është gjithmonë gati t'i mbështesë klientët dhe punonjësit. Kjo aftësi bazohet edhe në pozitën tonë si anëtar i mirënjohur i Grupit TEB. Grupi u formua përmes një sipërmarrjeje të përbashkët ndërmjet BNP Paribas, një prej institucioneve financiare më të fuqishme në botë, dhe Turk Ekonomi Bankasi, një prej bankave me më shumë reputacion në Turqi.

Synojmë të jemi bankë e përgjegjshme. Për këtë arsye zhvillojmë një sërë aktiviteteve me përgjegjësi sociale që kontribuojnë në zhvillimin social. Për TEB-in, përgjegjësia sociale e korporatës është një mjet shumë i vlefshëm dhe thelbësor që plotëson misionin tonë ekonomik. Prandaj, përveç ofrimit të një shërbimi të shkëlqyer, inovativ dhe të përgjegjshëm për klientët tanë, ne ndërmarrim projekte të dizajnuara për të sjellë përparim në arsim, kulturë dhe sport - gjithmonë me synim për ndikime pozitive për sa më shumë njerëz në Kosovë.

### Vlera, Shërbimi, Ekselencia...

Për TEB-in, klienti është në qendër të gjithçkaje ne bëjmë. Klientët tanë janë të posaçëm dhe të vlerësuar. Kjo shprehet në të gjitha produktet dhe shërbimet e dizajnuara

në mënyrë të posaçme që ne ofrojmë për grupe të ndryshme të klientëve, nga ndërmarrësit tek qytetarët më të moshuar, nga punonjësit tek studentët.

Rritja sistematike, vit pas viti në rrjetin tonë të shërbimit, numrin e klientëve, vëllimin e transaksioneve dhe burime njerëzore konfirmon se ne:

- Vazhdimisht zgjerohet diapazonin e produkteve dhe shërbimeve tona bankare jo në degë dhe i shtojmë funksionalitetin rrjetit tonë inovativ të shërbimeve bankare me shumë kanale. Ne ofrojmë të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare të fokusuara në cilësi, të cilat njerëzve iu duhen në faza të ndryshme gjatë jetës së tyre - e gjitha përmes rrjetit tonë të zgjeruar dhe me shumë kanale të ofrimit.
- Ofrojmë zgjidhje financiare optimale për klientë privatë të bankës bazuar në një "shërbim të personalizuar".
- Performojmë më mirë se industria sa i përket rritjes në kartelat e kredisë, rritje që shtohet vazhdimisht me produkte dhe shërbime të reja, si dhe me fushatat specifike të kartelave të organizuara me një grup tjetër të klientëve, anëtarët tanë tregtarë. Përmes segmentimit të biznesit me kartela, ne i identifikojmë grupet specifike, u shërbejmë atyre me produkte si SheCard për zonjat, ose Business Card për pronarët e NVM-ve.
- Ruajmë pozitën tonë të fortë në shërbimet menaxhuese të parasë së gatshme me shërbimet me pakicë.
- Ofrojmë mbështetje bankare komerciale që është shtytësi kryesor në udhërrëfyesin drejt rritjes ekonomike të ardhme në Kosovë. Çdo vit, përforcojmë fokusin tonë tashmë të fortë në mbështetjen e qindra mijërave klientëve komercialë dhe NVM të TEB-it, sepse ata luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik.

### Duke pasur parasysh këta faktorë, ne ishim të parët që prezantuam:

- një program i përkrahjes së ndërmarrësisë së grave. Është projektuar posaçërisht për të fuqizuar pjesëmarrjen e grave në biznes pasi përfshin elemente financiare dhe jo-financiare, në formën e trajnimeve dhe konsulencës. Këtë program e kemi përmirësuar më tej përmes partneriteteve me shumë partnerë ndërkombëtarë të besueshëm, prandaj luajmë një rol madhor në tregun Gratë në Biznes.
- një kartelë kreditit Agro që iu mundëson fermerëve blerjen e inputeve të tyre me këste, teksa rrit arkëtimin e parave të gatshme për tregtarët që i shesin ato inpute.
- koncepti i Akademisë së Biznesit synon të rrisë kompetencat e sektorit të NVM-ve dhe u ndihmon atyre të rrisin biznesin e tyre.
- një kartelë krediti me këste të quajtur Star Card që pati shumë ndikime në shumë nivele të shoqërisë në Kosovë: ka ndihmuar në rritjen e konsumit, rritjen e qarkullimit të kompanive dhe në mënyrë indirekte ka mundësuar kufizimin e mëtejshëm të ekonomisë joformale të vendit.
- një Sistem debiti direkt që i ndihmon kompanitë të ruajnë likuiditetin e tyre përmes një sistemi vetë-monitorues për të ulur kostot e tyre të financimit;

Kjo strategji e inovacionit në produkte dhe shërbime e dallon TEB Sh. A. nga konkurrenca dhe ka krijuar një prani unike në treg.

### E vërtetë, e mençur, me vlerë...

Si anëtare e dy grupeve të fuqishme ndërkombëtare financiare – TEB A.S., institucion financiar kryesor dhe me reputacion të lartë në sektorin bankar turk,

dhe BNP Paribas, një nga bankat e nivelit më të lartë të eurozonës me një rrjet të gjerë dhe ndërkombëtar – TEB përfiton nga përvoja, soliditeti dhe diapazoni i Grupit. Kjo na mundëson gjenerimin e rezultateve më të larta për klientët tanë.

Pas tetë vitesh të suksesshme në Kosovë, TEB Sh.A. (TEB) ka bërë emër në sektorin bankar, duke fituar reputacion bukur të merituar për shërbim të shkëlqyer.

Mbi këto baza të shëndosha, TEB-i vazhdon të përparojë duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe duke zhvilluar produkte të përshtatura me pritjet e klientëve. Në hap me avancimet e shpejta në teknologji, ne sistematikisht përmirësojmë rrjetin tonë inovativ dhe me shumë kanale të shërbimeve bankare (si shërbimet bankare në internet dhe ato mobile, Qendra e thirrjeve, Shërbimet SMS, Bankomatët, POS-et) duke iu lejuar klientëve të përdorin kanalin më të përshtatshëm të shpërndarjes për transaksionet e tyre bankare - me leverdi, shpejtësi dhe të besueshmëri.

### Më shumë përkushtim për komunitetin...

Prej themelimit të TEB-it në 2008-ën, qasja jonë ka qenë sjellja e risive. Si një bankë e fuqishme me shërbime të plota, jemi fokusuar në zgjidhjen e kërkesave të klientëve për shërbime financiare. Me kalimin e viteve, kemi arritur t'i shfrytëzojmë me efektivitet kompetencat dhe vizionin tonë të korporatës, duke prodhuar vlerë të shtuar si për klientët ashtu edhe për aksionarët. Në vitin 2015, vazhduam të rritemi të balancuar

dhe të shëndetshëm – çka pritet prej nesh - duke përforcuar më tej pozitën tonë si institucioni financiar më i fuqishëm në vend. Kjo na jep një bazë edhe më të fortë për të ardhmen tonë si një forcë e rëndësishme në Kosovë.

Përgjegjësia sociale e korporatës luan një rol të rëndësishëm. Politika jonë është të kontribuojmë në zhvillimin shoqëror të Kosovës. Kemi krijuar një kornizë për iniciativa afatgjata bazuar në spektrin e projekteve që do të krijojnë përfitimet më të mëdha sociale. Në lidhje me mbështetjen e biznesit, jemi duke punuar përmes programit të mbështetjes së ndërmarrësisë së grave, akademisë së biznesit dhe forumit të biznesit.

Angazhimet tona në fushën e sportit përfshijnë bashkëpunimin me Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe mbështetjen për turneun e tenisit "Dielli TEB Open". Kompanitë tona mëmë, TEB AS dhe BNP Paribas, prej kohësh janë sponsorë afatgjatë të turneve ndërkombëtare të tenisit. Në fushën e arteve, përkrahim projektin muzikor

Hand-to-Hand. Prej 2010-ës TEB-i është lidhur me Vihuela Guitar Festival dhe sigurojmë sponsorizim për këtë festival prestigjioz të videove muzikore.

## Tejkalojmë pritjet tuaja...

Suksesi i TEB-it varet nga punonjësit tanë, të cilët përcjellin tek klientët qasjen tonë inovative dhe proaktive, dhe punojnë shumë për ta ruajtur e rritur cilësinë e shërbimeve dhe aseteve të përfaqësuar nga emri i brendit tonë. Qëllimet tona janë t'u ndihmojnë individëve dhe bizneseve të ndërtojnë të ardhmen e tyre, të realizojnë ambiciet e tyre si dhe t'u ndihmojmë të menaxhojnë rreziqet e tyre financiare. Duam të jemi një institucion financiar që i bën klientët të ndihen rehat.

Me 26 degë, 56 banokomatë, 3.696 terminale POS dhe ekipin tonë të menaxherëve të marrëdhënieve, të cilët ofrojnë këshilla dhe shërbime të përshtatura për klientët tanë, besojmë se ky rrjet i gjerë vendor i ofrimit të shërbimeve përkufizon fuqinë e shkallës dhe ofrimit të shërbimeve të TEB-it.

Për TEB-in, klienti është në qendër të gjithçkaje ne bëjmë.

**Klientët tanë janë të posaçëm dhe të vlerësuar.**

Kjo shprehet në të gjitha produktet dhe shërbimet e dizajnuara në mënyrë të posaçme që ne ofrojmë për grupe të ndryshme të klientëve.



## 1.2 Vizioni, misioni dhe strategjia jonë

### Vizioni ynë

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë.

### Misioni ynë

Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë.

### Strategjia jonë

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është që të ofrojmë një përvojë të jashtëzakonshme dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë. Këtë do ta arrijmë duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe praktike për të siguruar rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Oferta e TEB-it është gjithmonë e bazuar në zotimin tonë për të qenë bankë e përgjegjshme. Kjo është e mishëruar në të gjitha vlerat tona dhe pasqyrohet në biznesin tonë, në mënyrën si i zhvillojmë produktet dhe shërbimet tona dhe si i paraqesim qëllimet dhe premtimet tona.

**Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë  
të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët,  
punonjësit dhe shoqërinë tonë.**

## 1.3. Vlerat tona themelore

### Klienti në qendër

Suksesi ynë është i bazuar në përkushtimin e plotë për klientët tanë në çdo kohë, duke fituar besimin dhe besnikërinë e bazës sonë të klientëve. E ruajmë këtë besim, sepse klientët tanë janë të parët në gjithçka bëjmë. Nevojat dhe pritjet e klientëve janë shtysat e qasjes dhe përgjigjeve tona të shpejta dhe proaktive ndaj kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo na mundëson të krijojmë dhe të japim vlerën e vërtetë teksa u shërbejmë klientëve tanë me shërbime dhe produkte të reja, përtej pritjeve të tyre, të përshtatura dhe të trendit të fundit.

### Integriteti

Kemi përqaftuar standardet më të larta të integritetit në çdo gjë që themi dhe bëjmë dhe jemi të përkushtuar për të krijuar vlerë të shtuar për klientët, aksionarët dhe punonjësit tanë duke bërë gjithmonë më shumë se thjesht atë që është e drejtë. Komunikojnë hapur dhe me ndershmëri, i ftojmë dhe i vlerësojmë pikëpamjet sfiduese që kanë për qëllim krijimin e ideve më të mira dhe marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe të balancuara.

Krijojmë vlerë për aksionarët tanë përmes suksesit afatgjatë e jo përmes fitimit afatshkurtër. Pra, qëllimi ynë është që biznesi ynë kryesor të realizojë dividendë e rentabilitet operativ të shëndetshëm e të fuqishëm përmes një fryme të ndërmarrësisë që me përgjegjësi balancon rreziqet dhe fitimet.

### Inovacioni

Aspirojmë inovacione me rëndësi. TEB-i vlerëson entuziazmin e kombinuar me kureshtjen intelektuale të personelit tonë, gjersa ata vazhdimisht synojnë të krijojnë produkte që lehtësojnë suksesin e klientëve tanë dhe ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për nevojat e tyre.

### Efikasiteti në punë

Krijojmë procese dhe produkte miqësore për përdoruesin, të lehta për qasje dhe të projektuara për të shtuar vlerë. Përpiqemi të sigurohemi se shërbimet që ofrohen për klientët tanë kanë çmime që u përgjigjen dëlirësisht kostos aktuale të ofrimit të tyre.

### Disiplina

We think and act like owners of the Bank, so Mendojmë dhe veprojmë si pronarë të Bankës që t'i mbrojmë burimet e saj dhe të përqendrohemi në qëllimet e përbashkëta dhe jo ato individuale. Jemi krenarë për sukseset e TEB-it dhe vlerën që krijojmë për aksionarët dhe klientët tanë. Secili nga 585 punonjësit tanë ndihet përgjegjës nëse dështojmë në përmbushjen e pritjeve të klientëve dhe të gjithë japim llogari për përmbushjen e premtimeve tona - nuk ka justifikime. Synojmë të arrijmë përsosmëri operative duke e kryer punën mirë që në përpjekjen e parë.

### Burimet njerëzore kompetente

Synojmë të forcojmë pozitën tonë si punëdhënës i zgjedhur dhe përpiqemi të krijojmë një kulturë që tërheq individë të talentuar, nxit punën bashkëpunuese e të zhdërvjellët ekipore përmes diversitetit dhe përgjegjësisë, edukojmë dhe investojmë në talentet më të mira, dhe menaxhimin e bazojmë në merita dhe mundësi të barabarta.

## Partneriteti

Synojmë që me klientët dhe punonjësit të kemi marrëdhënie të qëndrueshme dhe reciprokisht të dobishme, në të cilat vlera e krijuar ndahet dëlirësisht. Jemi partnerë të përgjegjshëm me të gjitha palët e interesuara dhe rregullatorët, dhe i shërbejmë shoqërisë.

## Kanalet e fuqishme të shpërndarjes

Përpiqemi të ofrojmë shërbime dhe përkrahje për klientët tanë siç iu përshtatet atyre, duke ofruar kanale të ndryshme të shpërndarjes, duke përfshirë zyrat tona të degëve, qendrën e thirrjeve, shitjet e drejtpërdrejta dhe kanalet e ndryshme alternative të shpërndarjes.

## 1.4. Struktura aksionare

Kapitali aksionar i Bankës është 24.000.000 € bazuar në 2.400.000 aksione të emetuara, secili me vlerë nominale 10 €. Numri i aksioneve lidhet me aksionet e zakonshme pa të drejta, preferenca ose kufizime të lidhura me to.

| Shareholder as of June 24 2014 | Shares ownership paid in capital (€) | Share |
|--------------------------------|--------------------------------------|-------|
| TEB Holding A.Ş.*              | 24,000,000                           | 100%  |

\* 50%-50% BNP Paribas Fortis Yatırımlar Holding A.Ş.and Çolakoğlu Group Joint Venture

# Panorama e 2015-ës dhe perspektiva e 2016-ës

## 2.1. Pasqyra makroekonomike

Presim që gjatë 2016-ës ekonomia globale të rritet më ngadalë se gjatë 2015-ës. Dy faktorë kryesorë kanë qenë dominues në këtë ngadalësim. Së pari, është ngadalësimi ciklik në ekonominë e Kinës, i prirë nga sektori i patundshmërisë dhe i zmadhuar nga shtrëngimi fiskal pro-ciklik i zbatuar nga qeveritë lokale kineze. I kombinuar me një politikë të ribalancimit të ekonomisë duke iu larguar sektorit të prodhimit që varet shumë nga importi e duke lëvizur drejt shërbimeve, ky ka çuar në një ngadalësim të mprehtë të kërkesës industriale. Rritja nominale e PVB-së vit në vit ishte vetëm 5.8% në TM4 2015, një rënie prej rreth 4.4pp krahasuar me TM4 2013. Faktori i dytë është shtrëngimi i fortë global monetar që nga 2014-a, i udhëhequr nga Rezerva Federale e SHBA-ve ('Fed'-i). Deri kohët e fundit, ky nuk ishte manifestuar në norma më të larta të fondeve të FED-it, por me shtrëngimin e përfaqësuar nga terezitja e programit të lehtësimit sasiar të Fed-it (madje edhe më parë, nga paniku i terezitjes gjatë 2013-ës) dhe pritjen për norma më të larta në SHBA. Kushtet financiare dhe monetare në SHBA janë shtrënguar rëndë dhe, çka është jetike nga perspektiva globale, USD është rritur së tepërmi.

Luhatshmëria tronditi tregjet financiare në fillim të vitit 2016. Pesimizmi në tregje ishte i lartë teksa ekuiteti ra dhe çmimet e naftës kapën nivele edhe më të ulëta, teksa RMB (Yuan) dhe valutat e tjera EM u zhvleftësuan kundrejt dollarit amerikan, dhe tregjet e kredive treguan shenja të stresit. Trazirat e tregut në fillim të vitit bënë që bankat e mëdha qendrore të marrin kthesa të forta. Komiteti Federal i Tregut të Hapur (FOMC) pezulloi rritjet e tija të normave dhe u bë më i kujdesshëm në lidhje me asimetrinë e rreziqeve përmes opinionit të shprehur në mbledhjen e marsit. Duke pasur

parasysh perspektivën jo të mirë ekonomike dhe pasigurinë e vazhdueshme globale, vazhdojmë të mendojmë se nuk ka gjasa për rritje të normave këtë vit dhe vitin e ardhshëm.. Gjatë marsit, Banka Qendrore Evropiane (BQE) e zbuti më tej politikën e saj, duke ulur normat e saj kryesore dhe duke zgjeruar programin e blerjes së aseteve. Trysnia e vazhdueshme e rritjes së vlerës së jenit japonez mund ta nxisë Bankën e Japonisë (BJ) që edhe ajo të mbështetet në zgjerimin e mëtejshëm monetar. Një nga shqetësimet kryesore globale mbetet stabiliteti i kursit të RMB-it. Të dhënat e fundit tregojnë shenja përmirësimi në ekonominë kineze, ndërsa indeksi PMI u rrit mbi pragun 50 në mars. Për më tepër, trysnia e zhvlerësimit të RMB-it është lehtësuar dhe, si rezultat rezervat e valutës së huaj të Bankës Popullore të Kinës u rritën gjatë marsit për herë të parë në pesë muaj. Por, ekonomia kineze nuk është ende jashtë rrezikut dhe mund të jetë sërish burim shqetësimi për shkak të problemeve të saja strukturore. Tregjet në zhvillim duhet të mbeten të shqetësuara nga rritja e dobët, çmimet e ulëta të mallrave dhe borxhi i rëndë në USD. Rreziku i kredive në tregjet në zhvillim dhe tregjet e zhvilluara kërkon kujdes. Megjithatë, vazhdimi/lehtësimi i mëtejshëm me politika të lirshme monetare të bankave qendrore kryesore do të mbështesë kërkesën për asete EM.

Në eurozonë ekonomia mbetet larg nga potenciali i saj, pritjet e inflacionit po duken të brishta dhe inflacioni bazë është shumë i ulët. Teksa inflacioni i përgjithshëm ka të ngjarë të rimëkëmbet, inflacioni bazë duhet të mbetet pothuajse i sheshtë gjatë 2016-ës dhe 2017-ës. Në këtë sfond, Presidenti Draghi i BQE-së sinjalizoi se pengesa për uljen e normave është më e lartë, dhe se favorizohen politika të tjera të pazakonta. Zgjatja e datës së referencës për programin e blerjes së aseteve duket si hapi më i mundshëm i ardhshëm, ndoshta në shtator.

## 2.2. Mesazhi i Kryetarit

TEB Sh. A. - Që nga themelimi i saj tetë vjet më parë, tipari më dallues i Bankës ka qenë ekspertiza e saj në fushën e diversifikimit të shërbimeve bankare. TEB Sh. A. bashkon ekspertizën globale me fuqinë e saj punëtore të re e profesionale, të aftë për të vepruar në nivel lokal.

Të nderuar klientë, partnerë të biznesit dhe aksionarë,

TEB Sh. A. ka vazhduar gjatë vitit 2015 të krijojë vlerë të shtuar të qëndrueshme e të lartë për ekonominë e Kosovës dhe, të kontribuojë në zhvillimin e Kosovës jo vetëm duke kuptuar përgjegjësinë financiare, por edhe përmes përgjegjësisë korporative sociale.

Gjatë vitit 2015, TEB Sh. A. ka vazhduar t'i identifikojë saktë nevojat e klientëve të saj dhe t'i shfrytëzojë të gjitha aspektet e teknologjisë për ta dalluar veten në sektor, duke u ofruar klientëve të saj produkte dhe shërbime të reja. Duke vazhduar qasjen e saj të shërbimeve bankare me klientin në qendër, TEB Sh. A. realizoi rritje të fortë dhe rentabilitet të shëndetshëm në vitin 2015. Banka shënoi rritje vjetore prej 8,9% në kredi dhe 9,1% rritje vjetore në depozita. Gjatë vitit 2015, TEB Sh. A. realizoi kthim mesatar të ekuitetit prej 51,09%, dhe raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16,74%.

Rritja ekonomike e Kosovës ka qenë e qëndrueshme. Dërgesat dhe rrjedhat e tjera nga diaspora e Kosovës, sidomos nga Evropa qendrore dhe veriore, janë veçanërisht të konsiderueshme dhe pritjet të mbeten të qëndrueshme. Zgjerimi i aktiviteteve të sektorit privat dhe produktivitetit është me rëndësi kritike për rritjen ekonomike të vendit. Në këtë pikë, TEB Sh. A. luan rol vendimtar në perspektivat e rritjes dhe të ardhurave. Teksa Banka evoluoi në institucion me shërbime të plota, sistematikisht ka përshtatur produktet dhe shërbimet e veta për ta përkrahur stabilitetin ekonomik dhe rritjen ekonomike.

Pjesa më e madhe e kompanive në Kosovë nuk janë ende në gjendje të konkurrojnë me sukses në tregjet lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Në përgjigje të këtij realiteti, TEB Sh. A. organizon për klientët e saj eventet e "Akademisë së Biznesit", të cilat përfshijnë seminare për strategjitë e rritjes dhe menaxhimin e ndryshimeve. Këto ngjarje janë të përqendruara në praktikat më të mira dhe njohuritë e menaxhmentit që kanë për qëllim optimizimin e vendim-marrjes nga pronarët e bizneseve. "Akademia jonë e Biznesit" shënon një qasje të re për marrëdhëniet me klientë që do të ofrojë trajnime dhe konsultime të rregullta.

Si një nga lojtarët më kryesorë në sektorin bankar të Kosovës, TEB Sh. A. do të vazhdojë të përcjellë nga afër trendet globale. E në të ardhmen, do të mbetet një nga bankat më inovative në këtë sektor. Prioriteti i Bankës është që të kontribuojë në ekonominë e Kosovës dhe të shfrytëzojë burimet për të përmbushur kërkesat e ekonomisë reale.

TEB Sh. A. ka krijuar reputacion për ekselencë përmes paraqitjes së vazhdueshme të produkteve dhe shërbimeve inovative dhe përmes punonjësve të saj shembullorë. Në vitin 2015, ky reputacion si "Banka më e mirë në Kosovë" është njohur nga një numër i

konsiderueshëm publikimesh prestigjioze, si The Banker-Financial Times, Euromoney, dhe Global Banking and Finance. Këto çmime janë mirënjohje të jashtme të industrisë bankare për Bankën tonë dhe arritjet e saja. Sa i përket performancës së TEB SH.A. gjatë 2015-ës, besoj fuqimisht se Banka është sigurisht në garë për të njëjtat çmime edhe vitin e ardhshëm.

Në emër të TEB Sh. A., dëshiroj t'i përgëzoj të gjithë kolegët e mi, të cilët edhe një herë kanë përforcuar pozitën dhe mbarëvajtjen e Bankës gjatë 2015-ës dhe kanë hedhur themele edhe më të forta për të ardhmen. Viti në shqyrtim, 2015-a, ishte mandati im i fundit si Kryetar i TEB Sh. A., një pozitë që jam krenar që e kam mbajtur që nga nëntori 2010. Jam i bindur se sukcesi aktual i Bankës do të vazhdojë në të ardhmen. Dëshiroj të falënderoj çdo anëtar individual të Bordit të TEB SH.A. për kontributin e tyre dhe mbështetjen që ia kanë dhënë Bankës TEB Sh.A. Urimet e mia janë për Menaxhmentin Ekzekutiv dhe personelin e TEB Sh.A., të cilët po ndërtojnë bankën më të mirë në Kosovë - çdo ditë.

Klientëve tanë, partnerëve të biznesit dhe të gjithë homologëve të cilat na janë bashkuar gjatë këtij udhëtimi, u shpreh mirënjohjen time të sinqertë për besimin dhe mbështetjen.



Musa Erden

Kryetar i Bordit të Drejtorëve

## 2.3. Letër nga Drejtori ekzekutiv

Të gjithë jemi plot energji dhe shumë të motivuar që ta çojmë Bankën tonë drejt arritjeve edhe më të mëdha.

Të nderuar klientë, partnerë të biznesit dhe aksionarë,

Prej themelimit tetë vjet më parë, TEB SH.A. është kthyer në një nga “brendet më të vlefshme në Kosovë”. Përmes risive, përparimeve të shumta teknologjike, produkteve inovative dhe ofertave për shërbime që kemi sjellë në sektorin bankar të Kosovës, TEB Sh. A. vazhdon të krijojë vlerë dhe të jetë e para me shërbime të reja, tash e në të ardhmen.

Përkundër faktit se viti 2015 ishte një periudhë e vështirë, TEB SH. A. e vazhdoi rolin e saj në mbështetje të ekonomisë së Kosovës pa kompromentuar qasjen e saj të kujdesshme të shërbimeve bankare. Nëpërmjet praktikave efektive të menaxhimit të rrezikut, politikave të kujdesshme dhe të matura të rritjes, TEB Sh. A. ka arritur të krijojë vlerë për të gjitha palët tona - klientët, aksionarët, partnerët dhe personelin.

Sajë natyrës evoluese të rregullimit të sektorit financiar dhe fokusit thelbësor në infrastrukturë dhe pajtueshmëri më të madhe rregullatore, viti i kaluar ishte larg të qenit një vit tipik. Megjithatë, TEB Sh. A. ishte ende në gjendje ta forconte më tej pozitën e saj në vitin raportues dhe vazhdoi t'i përforcojë themelet për të ardhmen.

Performanca jonë e fortë financiare gjatë vitit të kaluar pasqyron përparimin tonë të vazhdueshëm në ekzekutimin e strategjive tona. Kemi ofruar rritje të shëndetshme në bazë të parimeve të shëndosha. Produktet dhe shërbimet tona inovative na kanë mundësuar të gjenerojmë rezultate të forta, si në kredi ashtu edhe depozita. Deri në fund të vitit 2015, kreditë tona neto u rritën me 9.4% duke arritur 314 milionë € ose një pjesë të tregut prej 17.0%. Depozitat u rritën me 9.6% duke arritur në 342 milionë € dhe pjesë tregu prej 13.0%.

Përpyekjet tona janë vlerësuar në vitin 2015 me çmime nga organizata prestigjioze ndërkombëtare. Shpërblimet janë të rëndësishme, sepse ato masin performancën, qasjen dhe reputacionin tonë kundrejt standardeve të njohura ndërkombëtare. Në vitin raportues, TEB Sh. A. mori mirënjohje nga publikime dhe organizata si:

- **“Banka e Vitit 2015 për Kosovën”** nga revista autoritative The Banker, publikuar nga Financial Times, një nga burimet botërore kryesore për banka dhe financa.
- Çmimin i Ekselencës si **“Banka më e mirë - Kosovë”** nga revista Euromoney, një botim i rëndësishëm financiar ndërkombëtar.
- **Banka më e mirë për NVM në Kosovë 2015”** dhe **“Banka më e mirë për shërbime me pakicë në Kosovë 2015”** nga Global Banking and Finance (GBAF) Review, revistë online dhe e shtypur udhëheqëse për komunitetin financiar.
- **“Shpërblimi i ekselencës në biznes (Business Excellence Award), THE BIZZ 2015”** nga Konfederata Botërore e Bizneseve (WORLDCOB), një organizatë ndërkombëtare afariste me shërbimin dhjetë vjeçar për komunitetin botëror afarist.



Këto çmime po ashtu rikonfirmojnë aftësinë e bankës për t'iu përgjigjur nevojave financiare vazhdimisht në ndryshim të klientëve tanë, si dhe besnikërinë dhe besimin e tyre në institucionin tonë. Vlerësimi i tillë është jo vetëm dëshmi e progresit të ekipit tonë, por edhe e zgjidhjeve financiare inovative dhe e cilësisë që tashmë pritet prej nesh, dhe që ne do të vazhdojmë ta gjenerojmë për partnerët tanë bankarë.

Qasja e orientuar kah klienti në shërbimet bankare ka vazhduar gjatë tërë vitit 2015 në TEB SH.A. Aktivitetet tona në segmentet e shërbimeve bankare me pakicë dhe të kartelave të kreditit vazhdojnë të rriten me ritëm të shpejtë. Përmes fushatave të rregullta dhe të orientuara për segmente specifike, kemi qenë në gjendje të gjenerojmë rritje në numrin e klientëve aktivë. Kartelat e kreditit luajnë rol kyç për të ndihmuar njerëzit të menaxhojnë dhe planifikojnë angazhimet e tyre financiare.

Rritja e shpejtë e Teknologjisë së Informacionit (TI) i ka ndryshuar jashtëzakonisht shërbimet bankare dhe mënyrën si klientët i përdorin ato. Zbatimi kreativ dhe inovativ i TI-së së fjalës së fundit tani u mundëson klientëve të arrijnë të gjitha shërbimet e Bankës nëpërmjet kanaleve alternative që ofrojnë komoditet dhe janë të përshtatshme për përdoruesin. TEB Sh.A. ka identifikuar prej kohësh rëndësinë strategjike të alternativave ndaj shërbimeve bankare në degë. Përpunimi i transaksioneve dhe shërbimi për klientë po bëhen gjithnjë e më të pavarur nga kanali i degës. Për këtë arsye, Banka është duke vazhduar me investime të konsiderueshme në këto shërbime, të tilla si TebMobile, një shërbim përmes telefonit celular i nisur në vitin 2015. Përveç sigurimit të një përvoje më të mirë për klientët duke iu ofruar qasje më të lehtë dhe më të përshtatshme në shërbimet dhe ndërfaqet themelore, kjo gjithashtu na mundëson ta rrisim efikasitetin e shërbimeve tona.

Jemi duke plotësuar nevojat financiare të NVM-ve duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve, që dallohen për nga zgjidhjet inovative që u ofrojnë klientëve tanë. Shërbimet tona përfshijnë një gamë të plotë, nga menaxhimi i parasë së gatshme deri tek kreditë, investimet, transaksionet e huaja, si dhe kërkesat specifike të sektorit - të gjitha të ofruara përmes qasjes sonë të orientuar kah klienti.

Gjatë vitit 2015, gjithashtu kemi vazhduar të krijojmë rritje të qëndrueshme në segmentin e korporatave, duke përforcuar pozitën tonë të tregut në këtë sektor. Qëllimi jonë është ta rrisim besnikërinë e klientëve dhe pjesën e tregut duke ofruar produkte bankare dhe shërbime me cilësi të lartë në segmentet e korporatave dhe komerciale.

Të gjitha këto rezultate janë arritur nga punonjësit tanë. Ata janë arkitektët e suksesit tonë. Dhe nga klientët tanë, të cilët vazhdojnë të na japin besnikërinë dhe mbështetjen e tyre. Dëshiroj t'i falënderoj, ashtu si edhe të gjithë homologët tanë të tjerë, duke përfshirë edhe aksionarët tanë.

Faleminderit për një vit frymëzues.



Ayhan Albeyoglu  
Drejtori Menaxhues

# TEB SH. A gjatë 2015-ës

## 3.1. 2015-a me një vështrim

### 1) Një vit plot arritje

Performanca e suksesshme e TEB Sh. A. vazhdoi të fitojë vlerësime nga platforma të ndryshme ndërkombëtare në vitin 2015. Ishim krenarë që morëm një numër çmimesh prestigjioze ndërkombëtare. Ne i shohim ato si indikatorë që performanca e fuqishme financiare e TEB SH.A. është e vlerësuar në nivel ndërkombëtar. Këtu pason një vështrim mbi pikat më të rëndësishme

#### The Banker - TEB SH.A. - “Banka e Vitit 2015 në Kosovë”

Publikuar nga Financial Times, një nga burimet botërore më kryesore për banka dhe financa, The Banker i shërben sektorit financiar ndërkombëtar. Ky çmim është prezantuar më 2 dhjetor 2015 në Londër.

#### Euromoney - “Banka më e mirë - Kosovë”

Revista Euromoney është një nga publikimet kryesore financiare në botë. E morëm këtë çmim më 9 korrik 2015 në Londër.

#### WORLD COB - “Shpërblimi i ekselencës në biznes, THE BIZZ 2015”

Jemi shumë të kënaqur që na përzgjodhën për një nga çmimet më të rëndësishme botërore të ekselencës në biznes, THE BIZZ 2015 nga WORLD COB, një organizatë ndërkombëtare afariste me dhjetë vjet në shërbim të komunitetit të biznesit në mbarë botën.

#### Global Banking and Finance (GBAF) - “Banka më e mirë për NVM në Kosovë 2015” dhe “Banka më e mirë e shërbimeve me pakicë në Kosovë 2015”

Marrja e vetëm njërit prej këtyre çmimeve do të kishte qenë arritje. Por, marrja e çmimit edhe nga Global Banking and Finance (GBAF) Review, një revistë udhëheqëse online dhe e shtypur për komunitetin financiar, na motivon që të punojmë edhe më mirë në vitin 2016.

### 2) Inicimi i Programit për përkrahjen e grave ndërmarrëse

Përveç performancës sonë operacionale dhe financiare, ne i japim rëndësi të madhe edhe aktiviteteve të bazuara në parimin tonë që “duhet t’ia kthejmë të mirat shoqërisë”. Një nga këto aktivitete është programi ynë “Përkrahja për Gratë Ndërmarrëse”.

Ky program është projektuar posaçërisht për të fuqizuar pjesëmarrjen e grave në biznes pasi përfshin elemente financiare dhe jo-financiare, në formën e trajnimeve dhe shërbimeve këshilluese. Ky program ka filluar zyrtarisht në gusht, 2014. Me krijimin e programit kërkuam bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile me përvojë të konsiderueshme të punës në

këtë fushë. Kontributi dhe ekspertiza e tyre është përfshirë në komponentët e programit lidhur me fazat e organizimit dhe zbatimit. Përmes këtij bashkëpunimi, pjesëmarrëset tona janë në gjendje të marrin dhe të përfitojnë nga njohuritë e thella e të vlefshme dhe rrjetet e gjera që i kanë këto organizata të shoqërisë civile. Kemi vendosur bashkëpunim të afërt me:

- Organizatat ndërkombëtare financiare, si **Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)**;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në programe që zbatojnë dhe respektojnë standardet e shoqatave të tilla si **Shoqata e Biznesit të Grave - SHE-ERA, Oda Ekonomike e Grave të Kosovës - G7, Gratë për Gratë Internacional (WfWI) dhe Qendra Inovative e Kosovës (ICK)**.

### 3) Event promovimi nga Banka TEB

Për të gjithë ndërmarrësit tanë, kemi organizuar një event promovimi të krijuar në bashkëpunim me Bankën TEB, një nga kompanitë tona amë. Ideja ishte të nxitet dhe promovohet ndërmarrësia duke bashkuar afaristë aspirues teknologjikë me investitorë të mundshëm nga të gjithë sektorët. Kjo ngjarje, që shkon përtej rolit tradicional të bankierëve, shënoi fillimin e një cikli të mundësive të fokusuara në biznes për klientët tanë. Ajo pasqyron përkushtimin tonë ndaj klientëve afaristë dhe na mundëson të punojmë me investitorët për të krijuar instrumente të përziera private/bankare financiare për financimin e ndërmarrjeve për t'i arritur qëllimet e tyre të rritjes.

### 4) Memorandumi i bashkëpunimit me Universitetin Teknik të Stambollit

TEB Sh.A. ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Universitetin Teknik të Stambollit - ITUNOVA TTO (ITÛARI TEKNOKENT), ITU SEED (ITU ÇEKIRDEK) dhe TBAA për të përkrahur ndërmarrësit e rinj në zhvillimin e ideve të teknologjisë së informacionit.

Ky Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet TEB, Universitetit Teknik të Stambollit dhe Shoqatës së Engjëjve të Biznesit (Business Angels Association) të Turqisë ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit për zhvillimin e iniciativave të firmave të reja (startup) kosovare dhe ndërmarrësve në teknologji.

### 5) Ndërmarrësia dhe iniciativat e hapjes së bizneseve

TEB Sh. A. ka respekt të lartë për ndërmarrësit, sepse i sheh si krijues të vlerave të reja që mund të kenë efekte të shumëfishta pozitive në komunitet. Kjo është arsyeja pse kemi qëllim ta promovojmë ndërmarrësinë si një rrugë tërheqëse në karrierë dhe t'i inkurajojmë individët premtues për t'u angazhuar në të. Në vitin 2015, nisëm bashkëpunimin me Qendrën Inovative të Kosovës (ICK) dhe filluam mentorimin e ndërmarrësve për t'u ndihmuar në zhvillimin dhe përshtatjen e planeve të tyre të biznesit sipas kërkesave të investitorëve.

## 6) Akademia e Biznesit

Bazuar në qasjen tonë inovative dhe me qendër tek klienti, në vitin 2015 TEB Sh. A. vazhdoi të organizojë evenntet e “Akademisë së Biznesit”, që përfshijnë seminare për strategjitë e rritjes dhe menaxhimin e ndryshimeve. Këto ngjarje janë të përqendruara në praktikën më të mira dhe njohuritë e menaxhmentit që kanë për qëllim optimizimin e vendim-marrjes nga pronarët e bizneseve. Një qasje të re për marrëdhëniet me klientët u shënua nga “Akademia e Biznesit”, e cila do t’u ofrojë klientëve të biznesit trajnime dhe këshillime të rregullta.

## 7) TEB Sh. A. është pjesë e jetës kulturore, artistike dhe sportive të Kosovës

### TEB mirëpret U16 - Finalistët Evropianë

TEB-i ka një Memorandum Bashkëpunimi me Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), dhe tash është sponsori zyrtar për të gjitha kategoritë e sportit, veçanërisht të rinjtë. Qëllimi ynë është t’i ndihmojmë lojtarët e rinj të bëhen liderë në fushë dhe në jetë. Duam t’u japim modele për t’u ndjekur, duke theksuar rëndësinë e punës ekipore dhe të lojës së dliër dhe gjithashtu të stimulojmë arsimimin, për të ndërtuar karakterin dhe vendosmërinë për të arritur sukses në jetë.

Gjatë vitit 2015, na kanë vizituar një grup i basketbollistëve të U16, të cilët me krenari e kanë përfaqësuar Kosovën në Kampionatin Evropian 2015 dhe kanë arritur me sukses në finale.

### Shërbimi për turneun e tenisit “Dielli TEB Open”

Angazhimi i TEB-it për të rinjtë e Kosovës është rezultat i përkushtimit tonë ndaj përgjegjësisë sociale. Pasi që sporti është një aktivitet i shëndetshëm dhe efektiv për trupin dhe për trurin e njeriut, si dhe duke pasur parasysh numrin e madh të talenteve në Kosovë, ne përkrahim shumë ngjarje sportive, duke përfshirë lojtarët vendorë të tenisit.

TEB-i ka sponsoruar turneun e tenisit “Dielli TEB Open” për gjashtë vitet e fundit. Në vitin 2015, turneu shënoi vitin e tij të 14-të, por sponsorizimi i Bankës ka rritur edhe shpërblimet edhe nivelin e lojtarëve që garojnë tani. Lojtarët më të mirë nga Kosova janë në mesin e pjesëmarrësve që garojnë për titujt individualë dhe në dyshe.

Sponsorizimi është plotësisht në përputhje me politikën e përkrahjes nga TEB - BNP Paribas të suksesit të lojtarëve të rinj, sepse ata garojnë në fushë, në shkollë dhe në jetë.

### Sponsorizimi i festivalit prestigjioz të muzikës

Banka TEB sponsoron festivalin VIHUELA GUITAR FEST, një festival ndërkombëtar i videove muzikore, tani në vitin e tij të tretë. Duke sponsorizuar këtë festival prestigjioz - të mbajtur në datat 2 deri 4 qershor 2015 - TEB-i ndihmon të bashkohen të gjithë ata që kanë interesim për art dhe kulturë.

| TEB-i në shifra                                                         | 2015    | 2014    | Rritje/<br>(Rënie) | Përqindja |
|-------------------------------------------------------------------------|---------|---------|--------------------|-----------|
| <b>Indikatorët e bilancit të gjendjes</b>                               |         |         |                    |           |
| Gjithsej asetet                                                         | 410,576 | 369,343 | 41,233             | 11.1%     |
| Gjithsej kreditë (bruto)                                                | 340,215 | 312,421 | 27,794             | 8.9%      |
| Depozitat                                                               | 342,878 | 314,353 | 28,525             | 9.0%      |
| Ekuiteti i aksionarëve                                                  | 52,991  | 35,655  | 17,336             | 48.6%     |
| Kreditë joperformuese /<br>Gjithsej kreditë                             | 7.1%    | 7.3%    | (-0.2%)            | (-3.2%)   |
| Kreditë/Gjithsej asetet                                                 | 82.8%   | 84.5%   | (-1.7%)            | (-2.0%)   |
| Raporti i mbulimit të<br>kredive joperformuese                          | 93.2%   | 88.3%   | 4.8%               | 5.4%      |
| Të hyrat neto nga interesi                                              | 30,343  | 28,342  | 2,001              | 7.0%      |
| Të hyrat neto jo nga interesi                                           | 6,350   | 5,762   | 588                | 10.2%     |
| Raporti kosto/të hyra                                                   | 44.1%   | 46.2%   | (-2.1%)            | (-4.5%)   |
| Neto të hyrat bankare                                                   | 37,041  | 34,406  | 2,635              | 7.6%      |
| Neto fitimi vjetor                                                      | 17,336  | 9,261   | 8,075              | 87.2%     |
| <b>Raportet e rentabilitetit</b>                                        |         |         |                    |           |
| Kthimi në ekuitet                                                       | 51.0%   | 36.2%   | 14.8%              | 41.0%     |
| Kthimi në asete                                                         | 4.2%    | 2.5%    | 1.7%               | 68.4%     |
| Të hyrat neto nga interesi /<br>Asetet mesatare që krijojnë<br>interesi | 9.3%    | 9.4%    | (-0.1%)            | (-1.1%)   |
| <b>Raportet e likuiditetit</b>                                          |         |         |                    |           |
| Raporti i mjaftueshmërisë<br>së kapitalit                               | 16.7%   | 15.5%   | 1.1%               | 7.5%      |
| Asetet likuide/Gjithsej asetet                                          | 21.3%   | 20.3%   | 1.0%               | 5.0%      |
| Asetet e ponderuara sipas<br>rrezikut                                   | 349,247 | 321,589 | 27,658             | 8.6%      |
| <b>Indikatorët e tjerë</b>                                              |         |         |                    |           |
| Degët                                                                   | 26      | 25      | 1                  | 4.0%      |
| Punonjësit                                                              | 585     | 598     | (-13)              | (-2.1%)   |

### 3.3. Indikatorët financiarë kyç

Viti i raportimit 2015, më së miri mund të përshkruhet si një vit tjetër i rritjes së konsiderueshme, por të kujdesshme dhe me rrezik të ekuilibruar si fokus primar i Bankës. Kjo strategji e rritjes, e kombinuar me ruajtjen e kënaqësisë së klientit si objektiv kryesor, ka sjellë performancë të lavdërueshme në fitim, teksa u ruajt pozicioni jonë në vend të tretë në pjesën e tregut të kredive.

Në fund të vitit 2015, totali i aseteve të Bankës arriti 410,6 milionë €, duke u rritur me 41,2 milionë € ose 11,2% në krahasim me vitin 2014, dhe u mbajt madhësia e aseteve të Bankës në nivelin e synuar. Portofoli bruto i kredive u rrit në 340,2 milionë €, një rritje prej 8,9%, ose një rritje e volumit prej 27,8 milionë € mbi performancën e vitit të kaluar. Kreditë bruto tani përbëjnë 82,9% të totalit të aseteve të Bankës në bilancin e gjendjes së TEB-it.

**11.2%**

**Rritje e aseteve  
(€410.6M total)**

**48.6%**

**Rritje në  
kapitalin aksionar**

Raporti i kredive jo performuese (KJP) (kreditë mbi 90 ditë në vonesë) në fund të vitit 2015 ishte 7,1%, krahasuar me 7,3% në vitin 2014, një rënie prej 20 pikëve bazë. Depozitat totale të klientëve arritën në 342,9 milionë €, një rritje prej 28,5 milionë € ose 9,1% në krahasim me fundin e vitit 2014.

Gjatë vitit 2015 banka ka lidhur një marrëveshje kredie për 3 milionë € me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Qëllimi i kredisë është financimi i kreditimit për klientët për të nxitur ndërmarrësinë e grave.

Kapitali aksionar u rrit nga 35,7 milionë € në vitin 2014 në 53,0 milionë € në vitin 2015, për shkak të rritjes së fitimeve të mbajtura gjatë vitit. Në tërësi, kjo paraqet një rritje prej 48,6% në kapitalin aksionar në krahasim me vitin 2014.

Indikatorët e pasqyrës së të ardhurave gjithashtu tregojnë përmirësim të dukshëm në performancë në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat neto nga interesi arritën 30,3 milionë €, duke u rritur me 2,0 milionë € ose 7,0% në krahasim me vitin 2014, me gjithë trendin e vazhdueshëm të rënies në normat mesatare të interesit në kredi dhe depozita gjatë vitit 2015. Të hyrat neto jo nga interesi arritën në 6,3 milionë €, një rritje prej 0,6 milionë € ose 10,6% në krahasim me vitin 2014.

Raporti kosto të ardhura në vitin 2015 është ulur më tej në 44,1% nga 46,2% në vitin 2014, duke treguar rritjen e efikasitetit të Bankës dhe menaxhimit e vazhdueshëm të kujdesshëm të shpenzimeve operative.

Raporti kosto të ardhura në vitin 2015 është ulur më tej në 44,1% nga 46,2% në vitin 2014, duke treguar rritjen e efikasitetit të Bankës dhe menaxhimit e vazhdueshëm të kujdesshëm të shpenzimeve operative. Të hyrat neto nga shërbimet bankare në fund të vitit ishin 37,0 milionë €, në krahasim me 34,4 milionë € të realizuara në vitin 2014.

Banka përfundoi vitin me 17,3 milionë € fitim pas tatimit në krahasim me 9,3 milionë € në vitin 2013, ose një rritje prej 87,2%.

Sa i përket indikatorëve të profitabilitetit, në fund të vitit 2015 Banka ka gjeneruar kthim në ekuitet (KNE) me rentabilitet prej 51,1% krahasuar me 36,2% në vitin 2014, ndërsa kthimi në asete (KNA) qëndroi në 4,2% në krahasim me 2,5% në vitin paraprak. Raporti i Interesit neto mbi Asetet mesatare që krijojnë interes ishte 9,4% krahasuar me 9,5% në vitin paraprak. Sa i përket menaxhimit

të kapitalit të bankës në fund të vitit 2015, Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës (RMK) ishte 16,7%, (kërkesa minimale e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) është 12%) kundrejt 15,6% në fund të vitit 2014 për shkak të rritjes së fitimeve të mbajtura gjatë vitit.

Raporti i Aseteve likuide në krahasim me asetet totale ishte 21,4% në fund të vitit 2015 në krahasim me 20,4% në vitin 2014, ndërsa Asetet e vlerësuara sipas rrezikut (AVRr) arritën 349,2 milionë €, të rritura nga 321,6 milionë € në vitin paraprak pas rritjes në portfolin e kredive gjatë vitit 2015.

Në vitin 2015, Banka hapi një degë, duke rritur numrin e përgjithshëm të degëve në 26 (2014: 25), ndërsa numri i punonjësve është ulur pak në 585 në krahasim me 598 sa ishin në fund të vitit 2014.

**Banka përfundoi vitin me 17,3 milionë € fitim pas tatimit në krahasim me 9,3 milionë € në vitin 2013, ose një rritje prej 87,2%.**



# Njësitë e biznesit

Në bazë të qasjes sonë të orientuar kah klientët, TEB Sh.A. ofron të gjitha llojet e shërbimeve dhe produkteve që klientëve u nevojiten në faza të ndryshme të jetës së tyre

## 4.1. Shërbimet bankare për Individë

Gjatë 2015-ës, kemi vazhduar të ofrojmë dhe të zhvillojmë një spektër të gjerë të produkteve dhe shërbimeve inovative dhe plotësuese. Në të ardhmen, do të vazhdojmë të ofrojmë shërbime të shkëlqyera që kanë për qëllim ruajtjen e besnikërisë dhe kënaqësisë së klientit. TEB Sh. A. u shërben klientëve të saj me pakicë nëpërmjet brendit tonë të besuar e të fortë, rrjetit të gjerë të shpërndarjes dhe portofolit të produkteve dhe shërbimeve.

### Lidhja e partneritetit me klientët tanë

Klientët i japin kuptim misionit kryesor të shitjes me pakicë: të përkrahen dhe financohen edhe njësitë familjare edhe klientët individualë.

#### Qëllimi ynë është:

- të vazhdojmë përmirësimin e kënaqësisë së klientëve në degë dhe përmes kanaleve alternative të shpërndarjes;
- të jemi partnerë të vërtetë me klientët tanë të shitjes me pakicë dhe t'u ndihmojmë të investojnë, sepse janë këta klientë ata që do ta shtyjnë rritjen dhe punësimin në të ardhmen.

Inovacioni ka luajtur gjithmonë një rol qendror në aktivitetet e TEB Sh.A. dhe është pasqyruar në sloganin tonë: "Bankë për një botë në lëvizje". Në një mjedis të ngarkuar me krizë dhe pabarazi në rritje, një kompani

e madhe mund të jetë shtysë e progresit pozitiv, nëse është e angazhuar dhe e përqafon rolin e saj në shoqëri. Aktivitetet e shumta të shërbimeve bankare me pakicë në vitin 2015 e tregojnë këtë angazhim në veprim dhe e përforcojnë reputacionin tonë si një bankë e vendosur qartazi në shërbim të klientëve. Gjatë vitit, nisëm një numër fushatash që ofruan norma të volitshme dhe konkurruese, të përshtatura për të plotësuar nevojat e klientëve. Në partneritet me shkollat dhe universitetet, prezantuam Kreditë për Arsim me zero interes për financimin e pagesës së shkollës për studentët. Tani ofrojmë kredi hipotekare me norma shumë të volitshme interesi, me maturitet të përshtatur me të ardhurat e klientëve. Kjo do të thotë se pagesat nuk e mbingarkojnë buxhetin shtëpiak. Klientëve të shërbimeve me pakicë u ofrohen kredi konsumi që fillojnë me zero interes dhe u mundësojnë financimin e nevojave të tyre personale, duke përfshirë pajisje shtëpiake, automjete dhe projekte të tjera që kontribuojnë në mirëqenien e tyre. Për më tepër, vazhdojmë të ofrojmë për klientë të caktuar mundësi si pushimi nga pagesa

### Besimi i klientëve — Pasuria jonë më e vlefshme

Besimi dhe besnikëria e klientëve tanë janë asetet tona më të vlefshme. Besimi i tyre nuk është i rastit; kemi investuar dhe vazhdojmë të investojmë shumë në ndërtimin dhe ruajtjen e atij besimi gjatë viteve. TEB Sh.A. synon të fitojë besnikërinë e klientëve të cilët presin një marrëdhënie të personalizuar,

vlerësimin e besnikërisë së tyre dhe qasje optimale në Bankë. Kjo synohet edhe për klientët që po ngrenë pasurinë e tyre personale dhe, të cilët pas një kohe do të mund të bëhen klientë të menaxhimit të pasurisë. Në mjedisin e tashëm bankar, zhargoni dhe terminologjia e sektorit janë zakonisht norma gjatë komunikimit me një bankë. Ne mbështesim komunikimin përmes dialogut të bazuar në transparencë, ndershmëri, këshilla objektive dhe informacion të paanshëm dhe të sigurtë. E bëjmë këtë në gjuhë të drejtpërdrejtë, duke fuqizuar klientin për të marrë vendime të informuara. Këtë vit, hynë në fuqi ligjet dhe rregullat e reja për aktivitetet bankare. Përveç që i jemi përgjigjur të gjitha rregulloreve të reja, i kemi mbajtur klientët tanë të informuar për ndryshimet dhe pasojat e tyre praktike në aktivitetet bankare.

TEB Sh.A. Vazhdon ta rrisë pjesën e tregut duke paraprirë mundësitë e rritjes të ofruara nga tregu

Misioni ynë gjatë vitit të raportimit ka qenë të vazhdojmë të shtojmë vlerë dhe të ofrojmë produkte dhe shërbime inovative dhe lehtë të arritshme, veçanërisht përmes kanaleve alternative të shpërndarjes, të cilat plotësojnë nevojat e klientëve me pakicë dhe u ndihmojnë të arrijnë ambiciet e tyre - në mënyrën e duhur. Përkushtimi dhe angazhimi ynë është dëshmuar se është efektiv. Në vitin 2015, kemi fituar besimin e më shumë se 34.500 klientëve të rinj. Qëllimi ynë që t'i shërbejmë klientëve tanë me produkte dhe ide kreative ka pasur si rezultat një portofol kredish të papaguara prej 15,6 milionë € (2014: xxx milionë €). Portofoli i kredive hipotekare u rrit me 23% dhe portofoli i Auto Kredive u rrit me 28% në krahasim me vitin e kaluar.

Programi i shërbimeve bankare private (Private Banking) i filluar në vitin 2014 ofron produkte dhe shërbime në segmentin e sipërm të shitjes me pakicë për klientët dhe familjet e tyre, bazuar në konceptin e shërbimit të "privilegjuar". Programi ynë i shërbimeve bankare private (Private Banking) është projektuar për të përmirësuar mënyrën e jetesës dhe nevojat e klientëve në këtë segment dhe për të tejkaluar pritjet e tyre të cilësisë së shërbimit.

Kemi për qëllim të krijojmë një marrëdhënie afatgjatë me të gjithë klientët tanë individualë në mënyrë që të mund t'u ofrojmë këshilla dhe ndihmë të personalizuar. Megjithatë, përpiqemi edhe t'u kursejmë kohën duke vendosur shërbimet në dispozicion për lehtësinë e tyre pa pasur nevojë për të vizituar degët tona ose për të pritur në rresht për të kryer transaksionet e përditshme. Krahasuar me vitin 2013, kemi rritur përdorimin e platformës e-banking me 26%, ndërsa përdoruesit tanë të shërbimeve bankare me SMS janë rritur me 12%.

Produkti ynë risi në vitin 2015 ka qenë TebMobile. Ky është një kanal shtesë që ka përfitime edhe për klientët edhe për bankën. Ai ofron rritje të kënaqësisë së klientit duke i bërë transaksionet e përditshme më të lehta dhe zvogëlon rreshtat në sportelet e degëve tona.

## Ç'ka më tutje?

Për t'i shërbyer klientëve tanë me produkte dhe shërbime të reja e plotësuese, si dhe për të përkrahur rritjen tonë, në vitin 2016 dhe më tej do të vazhdojmë rivlerësimin në mënyrë sistematike të veprimtarisë bankare digjitale dhe mobile për të identifikuar më tutje potencialin për rritje në popullatën e re të Kosovës.

### Aktiviteti i ndërmjetësimit për sigurime

Synojmë të paraqesim produktet e sigurimeve duke vepruar si agjent ndërmjetës për kompaninë e sigurimeve SIGMA Interbalkan, e cila është pjesë e Vienna Insurance Group, dhe ofrojmë tri lloje të produkteve të sigurimeve:

- Kredi hipotekare për pronësi të pronës/shtëpisë;
- Kredi kasko për automjete/blerjen e automjeteve të reja
- Sigurim personal për aksidente për kredi konsumi

### Rritja e efikasitetit

Përmirësim i rrjedhave të brendshme të proceseve që lidhen me produktet, shërbimet, dhe aplikacionet e degës për të rritur efikasitetin duke zvogëluar shpenzimet dhe duke rritur konkurrueshmërinë tonë.

### Zgjerimi i gamës së kanaleve alternative të shpërndarjes

Vazhdojmë investimet tona në shërbime bankare jo në degë të tilla si e-banking, mobile banking, bankomatët, SMS, etj. dhe transformimin e teknologjisë në shërbim.

### Develop mortgage lending

Me përmirësimet në rregullimin e hipotekave, TEB do të krijojë potencial më të madh për ta rritur portfolion e vet kreditor

### Increase customer satisfaction

Tejkalim i pritjeve të cilësisë së shërbimit të klientëve individualë.

dëshmuar sërish si çelësi për një tjetër vit të shkëlqyer për biznesin tonë të kartelave. Duke kombinuar nevojat e klientëve me zhvillimet e reja teknologjike, kemi vazhduar të prezantojmë produkte të reja, shërbime të zgjeruara dhe kanale të reja të shfrytëzimit në mënyrë që klientët tanë të mund të kryejnë transaksione bankare sipas ritmit të tyre, kudo qofshin, pa kufizimet e imponuara nga orari tradicional i ofrimit të shërbimeve bankare.

Gjatë vitit 2015, prezantuam SheCard - një kartelë e veçantë në treg, e dedikuar vetëm për gratë, të cilat mund të blejnë me këste pa interes. Në këtë vit të parë, u lëshuan më shumë se 3.000 kartela SheCard për kliente. Mbajtëset e kartelës SheCard do të përfitojnë deri në 15% bonus, varësisht nga sektori tregtar dhe fushatat.

Një tjetër produkt inovativ që u prezantua për herë të parë në tregun tonë ishte International Credit Card (kartela ndërkombëtare e kreditit) me pagesa me këste. Klientët janë tani në gjendje të bëjnë blerje online në internet dhe në терминаlet POS jashtë vendit me kartelë të kreditit dhe të paguajnë deri në tri këste. Për ta përdorur këtë funksion, klientët janë të detyruar të regjistrohen për këtë shërbim në një zyrë dege.

Me një bazë klientësh në rritje, nevoja për të garantuar shërbime më të mira është prioritet. Prandaj, kemi zgjeruar ekipin tonë të shitjes direkte dhe aktivitetet e tij. Tani, jemi edhe më afër klientëve dhe të aftë për t'iu përgjigjur më shpejt dhe më besueshëm nevojave të tyre. Ekipi i shitjeve direkte

## 4.2. Biznesi i kartelave

Me mbi 19.000 kartela të reja të miratuara gjatë vitit 2015, Starcard mbetet kartela e kredisë më e preferuar dhe më e përdorur në treg. Pozita jonë si zgjedhja e parë e klientit na jep një përgjegjësi edhe më të madhe, për të qenë kudo janë klientët tanë dhe për t'i dëgjuar në mënyrë aktive nevojat e tyre. Kompetenca dhe ekspertiza pa rivalë, dëgjimi aktiv dhe aftësitë e zbatimit u

Me mbi 19.000 kartela të reja të miratuara gjatë vitit 2015, Starcard mbetet kartela e kredisë më e preferuar dhe më e përdorur në treg.

është gjithashtu në dispozicion për të ofruar informata për ofertat speciale për të cilat klienti mund të ketë të drejtë përdorimi. Gjithashtu, këshillon klientët mbi produktet dhe shërbimet e reja në dispozicion nga banka dhe që ne mendojmë se mund të jenë me interes dhe përfitim për ta. Gjatë gjithë vitit dhe në partneritet me tregtarët, Banka ka iniciuar fushata të shumta të personalizuar, duke ofruar propozime të ndryshme që paraqesin plane shtesë të pagesave, ulje, periudha të pritjes dhe produkte bonus. Jemi mirënjohës për besnikërinë e klientëve tanë, prandaj sërish kemi shpërndarë mbi 600.000 € (20% më shumë se në vitin 2014) në pikë bonusi në kartela ose si bonuse në forma të tjera. Gjatë vitit 2015, kemi ofruar kapacitet të pandërprerë të transaksionit përmes rrjetit tonë kombëtar prej 56 bankomatësh dhe 3.700 terminalesh POS, dhe nëpërmjet të gjithë bankomatëve, POS-ve ose rrjeteve të e-tregtisë në mbarë botën. Numri i transaksioneve përmes terminaleve POS është rritur me 12% në krahasim me vitin e kaluar dhe gjithsej qarkullimi i POS-ve është rritur 9%. Krenohemi me faktin se klientët janë shumë të kënaqur me shërbimet tona. Kjo ka çuar në depërtim edhe më të madh në treg dhe, në fund të 2015-ës banka jonë kishte lëshuar 81% të të gjitha kartelave aktive të kredisë në Kosovë. Tarifat dhe komisionet tona që lidhen me mirëmbajtjen dhe përdorimin e kartelave mbeten shumë konkurruese në treg dhe, gjithashtu ofrojmë një gamë të shumëfishtë të transaksioneve pa pagesë, si pagesat online dhe blerjet ndërkombëtare me kartelë të kredisë. Teksa teknologjia sofistikohet gjithnjë e më shumë, mashtrimi me kartela në të gjithë botën po përhapet me ritëm dinamik. TEB-i ka investuar shumë në siguri të avancuar për rrjetin tonë të infrastrukturës. Kjo menaxhohet nga ekipi ynë shumë vigjilent i monitorimit në kohë reale. Besojmë se siguria e transaksioneve është padyshim një nga sukseset tona, sepse transaksionet mashtruese në tentativë duke përdorur

kartelat tona dhe në rrjetin tonë mbeten konsiderueshëm nën tendencat e sektorit. Në vitin 2015 dhe si pjesë e përgjegjësisë sonë sociale, kemi vazhduar të rekomandojmë fuqishëm opsionin e gjendjes elektronike për klientët. Kjo redukton përdorimin e letrës dhe mbi 70% e gjendjeve tani dërgohen në mënyrë elektronike përmes e-mailit. Kjo do të thotë se mbi 360 pemë u shpëtuan në vitin 2015.

## Ç'ka më tutje?

Qëllimi ynë gjatë 2016-ës është ta ruajmë pozitën tonë si udhëheqës i tregut në biznesin e kartelave. Objektivi ynë është të lehtësohet procesi i pagesave dhe të rritet siguria kundër mashtrimit me kartela për këto transaksione. Për ta rritur sigurinë e pagesave me kartela, do të paraqesim një mundësi të pagesave me 3D Secure gjatë vitit 2016.

Gjatë 2016-ës do të fillojmë të lëshojmë Master kartela. Për të vazhduar traditën tonë të inovacionit dhe në bashkëpunim me MasterCard, edhe ne jemi duke futur të ashtuquajturin funksion pa kontakt. Metoda e pagesës pa kontakt u mundëson klientëve që të paguajnë nëpërmjet kartelës ose pajisjes pa e futur/tërhequr kartelën. Ky funksion rrit llogaritë e kredive, debive, llogaritë e para-paguara dhe komerciale dhe ofron një mënyrë më të shpejtë, më të thjeshtë për t'i paguar blerjet. Në anën blerëse synojmë rritjen e numrit të tregtarëve me sektorin që nuk ka qenë i mbuluar. Për tregtarët, blerja pa kontakt mundëson kalim më të shpejtë përmes arkës dhe shpenzim mesatar më të lartë, sepse klientët nuk janë të kufizuar në paratë që kanë për momentin.

Gjithashtu, do të implantojmë përgjigjen interaktive zanore (Interactive Voice Response (IVR)) si një teknologji që i mundëson kompjuterit bashkëveprimin me klientët tanë nëpërmjet përdorimit të inputeve zanore dhe tonale nëpërmjet tastierës.

### 4.3. Shërbimet bankare për NVM

#### **TEB-i lehtëson operacionet për NVM-të, fermerët dhe agro-bizneset**

Tregu i NVM-ve ka vazhduar të jetë shumë konkurrues në vitin 2015. Çmimet e produkteve dhe shërbimeve të ndryshme bankare kanë pësuar luhatje gjatë gjithë vitit. Me gjithë këtë mjedis të punës, sërish ishim në gjendje ta rrisim portfolion e përgjithshme të NVM-ve me 5,7 milionë €. Edhe tendenca në rënie e çmimeve të depozitave ka vazhduar. Në anën tjetër, tarifat e shërbimeve bankare në treg janë rritur dhe transaksionet janë kanalizuar më shpesh nëpërmjet kanaleve alternative të shpërndarjes (transfertat ndërkombëtare dalëse të parave përmes e-banking arritën në 27%, ndërsa transfertat dalëse vendore të parave nëpërmjet e-banking arritën në 48% në fund të vitit).

Klientët tanë NVM e shohin TEB-in si një bankë me qasje plotësisht të bazuar tek klientët dhe si një "one-stop-shop" apo sportel për të gjitha nevojat e tyre. Gjithnjë e më shumë klientët tanë kanë gjithnjë e më pak kohë për të menaxhuar aktivitetet e tyre bankare dhe kjo është arsyeja pse vazhdojmë të promovojmë shërbimet bankare elektronike, si një alternativë më e shpejtë dhe më efikase, jo vetëm pse këto shërbime përmirësohen vazhdimisht me karakteristika të reja që ofrojnë lehtësi më të mëdha.

TEB është e përqendruar në financimin e mikro-bizneseve të regjistruara, me struktura të forta organizative dhe potencial për rritje. Në afat më të gjatë, Banka do të fokusohet më shumë në bizneset e formalizuara dhe klientët e biznesit me kapacitet financiar prej më shumë se 10.000 €.

Gjatë vitit 2015, kemi ndërmarrë një proces intensiv të NjKT-së dhe kemi shqyrtuar

procedurat e tjera në mënyrë që TEB të jetë në përputhje me kërkesat e BNP Paribas. Për më tepër, kemi përfunduar me sukses një projekt po aq intensiv me qëllim të sinkronizimit dhe miratimit të politikave dhe procedurave të BNP Paribas; jemi aktualisht në proces të përditësimit të të gjithë dokumentacionit përkatës në përputhje me rrethanat.

TEB vazhdon të ofrojë produkte dhe shërbime inovative për klientët mikro, ndërmarrjet e vogla dhe klientët e bujqësisë dhe, që nga viti 2015 me një fokus të veçantë të gratë ndërmarrëse. Gjatë vitit të raportimit kemi ofruar një gamë të produkteve të reja për klientët tanë përmes fushatave të tilla si:

- Fushata për klientët e biznesit të përfshirë në sektorin e prodhimit;
- Fushata për klientët e biznesit të përfshirë në sektorin e shërbimeve;
- Fushata për klientët e biznesit me Kompaninë e Sigurimeve SIGAL;
- Financimi i Agro Granteve për klientët e bujqësisë, të cilët kanë përfituar nga grantet e Ministrisë së Bujqësisë;
- Fushata Agro Spring ku klientët kanë marrë testet e qumështit ose analizat e tokës;
- Fushatat me "Haxhijaha" dhe "Agribau" për financimin e blerjes së pajisjeve bujqësore;
- Fushata për gratë ndërmarrëse për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas (8 mars); dhe
- Bashkëpunimi me USAID-in për një Fond të Garancisë AKZH (Autoriteti kreditor i zhvillimit) për gratë ndërmarrëse në vlerë prej 1,7 milion dollarë.

Ashtu si në vitet e mëparshme, vazhdojmë të luajmë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për më tepër, jemi të angazhuar plotësisht për përgjegjësinë sociale në të gjitha operacionet tona bankare.



## Ç'ka më tutje?

Në të ardhmen, shërbimet bankare për NVM do të vazhdojnë të përqendrohen në të gjitha segmentet e biznesit me vëmendje të veçantë në sektorin e bizneseve të vogla dhe të bujqësisë. Qëllimi ynë është që të mbetemi banka kryesore për gratë ndërmarrëse dhe do t'i koordinojmë aktivitetet me homologë të tjerë relevantë që janë aktive në financimin e këtij segmenti të rëndësishëm.

**67% e totalit të transaksioneve të transfertave vendore janë kryer duke përdorur e-banking**

### 4.4. Shërbimet bankare komerciale dhe për korporata

Nëpërmjet marrëdhënieve të saja të afërta me klientët dhe qasjes së orientuar kah zgjidhjet, TEB Sh.A. është një lojtar mjaft i dukshëm në segmentin komercial dhe të korporatave. Në TEB, e pranojmë se ky segment i caktuar i klientëve është më i ndërlikuar sa i përket nevojave dhe kemi zhvilluar një strategji të zgjidhjeve të përshtatura dhe të avancuara të shërbimeve të menaxhimit të parasë së gatshme për t'u ofruar klientëve tanë një sistem të vlerës së shtuar që është me përfitim edhe për bankën.

Si në vitet e mëparshme, strategjia jonë në vitin 2015 u përqendrua në rritjen e pjesës sonë të tregut dhe profitabilitetit. Kjo e fundit u dëshmuar të jetë sfiduese, sepse tregu diktoi një rënie të konsiderueshme në normat e interesit, ndërsa numri i kufizuar i klientëve në këtë segment kërkon një qasje proaktive nga Banka. Rritja e kredive është përkrahur nga rritja në komisionet jo-nga interesi, ndërsa departamenti ka arritur një rekord prej 2,9 milionë €, apo një rritje prej 6% në krahasim me vitin e kaluar. Rritja e vazhdueshme në komisionet jo-nga interesi tregon se tregu e vlerëson ofertën cilësore të Bankës në shërbime të tilla si transfertat, pagesa me POS dhe transaksionet e tjera.

Banka ka vazhduar të ofrojë zgjidhje të avancuara të menaxhimit të parave, si një rrjet të zgjeruar POS, kartela të debitit dhe kreditit të diferencuara dhe të teknologjisë së fundit për biznes dhe e-banking me shumë karakteristika dhe opsione. Zgjerimi i kanaleve alternative të ofrimit të shërbimeve dhe rritja e zgjidhjeve të menaxhimit të parave është një qasje e rëndësishme strategjike për vitet e ardhshme, sepse tregu i biznesit po kërkon partneritete më efikase dhe më të gjera.

Një nga prioritetet e veçanta të Bankës në vitin 2015 ishte rritja e efikasitetit në operacione. Kemi investuar shumë kohë dhe përpjekje të konsiderueshme në promovimin e gamës së gjerë të opsioneve dhe përfitimeve të shumta që ofron e-banking për biznese. Kjo iniciativë ka rezultuar mjaft e suksesshme, sepse shumë klientë kanë marrë në përdorim e-banking për nevojat e tyre bankare të përditshme. Si rezultat, 67% e totalit të transaksioneve të transfertave vendore janë kryer duke përdorur e-banking, me 55,82% të transfertave ndërkombëtare duke përdorur të njëjtin kanal. Ky ndryshim në sjelljen e klientëve përbën një arritje të rëndësishme për departamentin, sepse zvogëlon ngarkesën e punës në degë dhe i mundëson ekipeve të degës të kalojnë më shumë kohë për këshillim dhe përkrahje për klientët.

Në forcimin e marrëdhënieve me klientët, Banka ka vazhduar ofrimin e shërbimeve jo-financiare në formën e “Akademisë së Biznesit”. Gjatë vitit 2015, kemi organizuar evente në Ferizaj dhe Prizren, ku klientët komercialë kanë pasur mundësi t’i rrisin aftësitë e tyre në fusha të tilla si menaxhimi strategjik, menaxhimi i rritjes dhe trendet aktuale të biznesit. Për më tepër, gjatë

promovimit të projekteve inovative të biznesit dhe duke inkurajuar diferencimin, në eventin tonë të promovimit Banka ka prezantuar tek investitorët e mundshëm korporata TI si klientë të përzgjedhur me potencial të lartë për rritje. Kjo tregon se fusha e bashkëpunimit me klientët korporata është e kufizuar vetëm nga kreativiteti dhe imagjinata, pasi mundësitë janë të pafundme.

## Ç’ka më tutje?

Kur shikojmë përpara në vitin 2016, parashohim një tjetër vit sfidues, sepse vendi po përballlet me tensione politike dhe ende ka luhate në normat e interesit. Megjithatë, jemi të përkushtuar për rritjen e bashkëpunimit tonë me segmentin e korporatave dhe kemi një ide të qartë se si të arrihet ky objektivi. Si bankë, do të vazhdojmë të mbështetemi në inovacion dhe zgjidhje të përshtatura për të arritur një pjesë më të madhe të biznesit të klientëve korporata dhe për ta rritur pjesën tonë të tregut dhe profitabilitetin. Në të njëjtën kohë, aktivisht do të synojmë projektet në sektorin e prodhimit dhe eksportit, sepse ata shihen si strategjikë për rritjen e mëtejshme të kompanive dhe gjithashtu për rritjen e përgjithshme të ekonomisë.

## 4.5. Financat tregtare

TEB Sh.A. e kupton se biznesi ndërkombëtar në një botë të globalizuar është sfidë - suksesi kërkon njohuri të gjera profesionale dhe një rrjet efektiv. TEB-i i ka të dyja.

Gjatë 2015-ës kemi vazhduar të përkrahim klientët tanë, duke krijuar dhe përshtatur zgjidhje të financave tregtare për nevojat e tyre të biznesit. Për më tepër, kemi punuar vazhdimisht në zgjerimin e rrjeteve tona, forcimin e marrëdhënieve me bankat e tjera, dhe ngritjen e mëtejme të standardeve tona të larta të profesionalizmit dhe kompetencës. Përkrahur nga prania globale dhe ekspertiza në tregtinë ndërkombëtare e BNP Paribas dhe TEB A.Ş., vazhdimisht zgjerojmë mbulimin tonë gjeografik dhe gamën e produkteve tona.

Produktet e financave tregtare për operacionet e biznesit dokumentar përfshijnë letër kreditë e importit dhe eksportit, skontimin në letër kredi, garancitë vendore dhe ndërkombëtare, letër kreditë në pritje

(stand-by) dhe arkëtimet. Marrëveshja e nënshkruar në 2011-ën me programin e tregtisë së Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC-së) na ka dhënë një mundësi të shkëlqyer dhe më shumë fleksibilitet për t’iu përgjigjur kërkesës në lidhje me letër kreditë e konfirmuara dhe kundër garancitë. Gjatë vitit raportues, gjithashtu kemi zgjeruar më tej marrëdhëniet tona me banka të reja korrespondente.

TEB Sh. A. e ka ruajtur përkrahjen tonë të vazhdueshme për klientët dhe synojmë të jemi gjithmonë partneri më i besueshëm dhe i preferuar i biznesit në Kosovë, duke vazhduar ta ndajmë profesionalizmin dhe ekspertizën në produktet e financave tregtare me klientët tanë, duke ofruar edhe zgjidhje inovative.

## Ç’ka më tutje?

Vitin e ardhshëm, do të vazhdojmë të mbështesim klientët tanë, duke siguruar një urë të sigurt për mundësi të reja. Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jenë



udhëzuesit tanë, sepse i shohim këto si diferencues në një botë që lëviz me shpejtësi. Gjithashtu, synojmë të shtojmë produkte të reja të tregtisë ndërkombëtare në gamën tonë të produkteve në vitin 2016.

## 4.6. Menaxhimi i parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse jemi duke investuar shumë në kanalet alternative të shpërndarjes duke zhvilluar dhe përmirësuar platformën tonë të shërbimeve bankare elektronike e-banking

Në një kohë të progresit të shpejtë teknologjik, TEB-i jo vetëm po e mban ritmin, por edhe i paraprin progresit në menaxhimin e parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave, gjersa vazhdon të shtojë kanale të reja të pagesave dhe mundësi për shërbime më të mira. Menaxhimi ynë i parave të gatshme dhe zgjidhjet për pagesa janë përshtatur për t'u ofruar klientëve tanë afaristë një gamë të produkteve dhe shërbimeve që do ta rrisë likuiditetin. Ne sigurojmë infrastrukturën e duhur për përpunim të shpejtë dhe të sigurt të pagesave. Për më tepër, duke shfrytëzuar zgjidhjet tona të teknologjisë së fundit klientët tanë krijojnë kursime të kostos dhe përfitojnë nga optimizimi i shpenzimeve operative direkte dhe indirekte.

### Sistemi i pagesave

TEB-i e para ka prezantuar sistemin e debitimit direkt (SDD) në Kosovë. SDD-ja është një produkt unik në treg dhe është i projektuar për të përkrahur bashkëpunimin komercial B2B (biznes me biznes). Funkcioni i saj kryesor është përmirësimi i likuiditetit

financiar të klientëve tanë të biznesit duke ofruar menaxhimin e plotë të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme. Ai konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi përkrahet nga teknologjia e ndërfaqet me të fundit që lehtësojnë procedimin e plotë dhe automatik të pagesës së faturave. Kjo u mundëson klientëve që të na autorizojnë për të debituar (tërhequr) automatikisht mjete direkt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore për kompani të ndryshme publike dhe private. Nevojitet vetëm një formular i autorizimit (i nënshkruar nga klienti) dhe transaksioni përkatës do të kryhet automatikisht. Klientët me SDD marrin linjë kreditore të dedikuara që mundëson pagesat për furnizuesit dhe garanton se kushtet e pagesës së faturës respektohen plotësisht. Hapi tjetër logjik ishte futja e skontimit të SDD-së që garanton të arkëtueshmet. Duke zbatuar skontimin e SDD-së, klienti konsolidon financat dhe përfiton nga arkëtimi i hershëm i të arkëtueshmeve.

Shërbimi ynë ultra-modern online shfrytëzon sistemet më të avancuara të sigurisë dhe jep qasje në shërbime bankare të sigurta, të përshtatshme dhe të shpejta, 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë. Klientët tanë mund t'i transferojnë fondet në mënyrë elektronike te përfituesit në mbarë botën dhe të procedojnë pagesa vendore, duke përfshirë pagesën e shërbimeve komunale dhe debi të tjera të rregullta, si rryma, uji dhe telefoni. Për më tepër, klientët mund të zgjedhin edhe të kryejnë pagesat për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) automatikisht duke përdorur e-banking.

Sot, transfertat e shpejta dhe të sigurta ndërkombëtare të parave janë me rëndësi të madhe për klientët me ambicie që tejkalojnë kufijtë. Kjo është arsyeja pse ofrojmë një shërbim që është mënyra më e lehtë, më e shpejtë dhe më e besueshme për të bërë

pagesa ndërkombëtare. Nëpërmjet rrjetit tonë të gjerë me mbi 100 marrëdhënie korrespondente të huaja dhe 10 banka për plasim, pagesat ndërkombëtare dalëse mund të kryhen për përfituesit e huaj në të gjithë botën. Si anëtar i SWIFT-it, rrjetit më të madh në botë të pagesave, klientët tanë gëzojnë një përparësi të qartë, sidomos në pagesat ndërkombëtare dalëse. Pagesat ndërkombëtare hyrëse mund të menaxhohen duke përdorur të njëjtin sistem. Kjo do të thotë se jemi në gjendje të ofrojmë shërbime të pagesave që janë udhëheqëse në treg, gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të brendshme shumë efektive dhe përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit tonë global.

Në vitin 2015, përsëri kemi marrë një çmim për cilësinë e lartë të pagesave tona ndërkombëtare dalëse nga KBC Bank, Belgjikë. Arritëm normën e jashtëzakonshme prej 99% STP. Çmimi vlerësoi transaksionet gjatë vitit 2014.

Zbatimi i Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN) u krye me sukses në fillim të vitit 2015 dhe prej shkurtit 2015 kemi filluar ta zbatojmë IBAN-in.

IBAN është një format i standardizuar ndërkombëtar për numrat e llogarive bankare i vendosur në përputhje me standardet ndërkombëtare të pagesave. Ai përdoret në nivel ndërkombëtar për të identifikuar llogarinë e klientit në një institucion të veçantë financiar dhe për të bërë pagesa jashtë vendit. IBAN-i përshpejton përpunimin e pagesave ndërkombëtare dhe redukton vonesat në këto procese. IBAN-i në Kosovë përfshin 20 karaktere alfanumerike. Duke përdorur këtë sistem, ne - dhe klientët tanë - do të jemi në gjendje të përmirësojmë ndjeshëm cilësinë e pagesave STP, veçanërisht për transaksionet hyrëse.

## 4.7. Thesari dhe MPD

### Menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve

Departamenti thesarit & menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve i TEB SH.A. përqendrohet në valutat e huaja në afat të gjatë dhe të shkurtër dhe likuiditetin në euro. Likuiditetit menaxhohet përmes huamarrjeve dhe plasimeve duke përdorur transaksione të tregut të parasë. Kjo siguron menaxhimin efektiv të fondeve afatshkurtra të Bankës, duke përdorur instrumente të ndryshme të tilla si kundërkëmbimet valutore.

Departamenti vazhdimisht menaxhon kërkesat e rezervës së Bankës në mënyrën më efektive. Përveç kësaj, departamenti vazhdon të angazhohet në financimin konsistent, për ta rritur bilancin e bankës dhe fleksibilitetin e kostos në përputhje me kushtet e tregut që vazhdimisht ndryshojnë. Thesari synon ta ruajë likuiditetin optimal në përputhje me zhvillimin e bilancit të gjendjes, pritjet për rritje dhe strategjitë e biznesit duke u fokusuar në raportet e ndryshme ligjore dhe të nivelit të bordit.

Jemi shumë të vetëdijshëm për rreziqet e mundshme dhe vazhdimisht monitorojmë dhe menaxhojmë rreziqet e likuiditetit, të homologëve, valutës së huaj, portofolit të të ardhurave fikse dhe normës së interesit që mund të shfaqen nga aktivitetet tona ditore. TEB Sh.A. punon nga afër me TEB A.Ş., duke përfituar nga parashikimet e sakta të tregut, veçanërisht për menaxhimin e normave të interesit dhe hendekun e likuiditetit.

Ekipi FTP menaxhon funksionin e çmimit të transferimit të fondeve për njësitë e tjera të biznesit të Bankës.

Ekipi i Marketingut të Thesarit u shërben klientëve në të gjitha segmentet, me një gamë të gjerë të produkteve që përfshijnë transaksione të këmbimit valutore,

transaksione të ardhme të këmbimit valutor, transaksione të kundërkëmbimit të valutës së huaj, obligacionet dhe bonot e qeverisë, plasimet dhe huazimet.

## Menaxhimi i rrezikut

Kontrolli i brendshëm i rreptë është çelësi për të gjitha aktivitetet tona të thesarit. Kemi zhvilluar dhe vendosur praktika të kujdesshme që zvogëlojnë dhe zbusin rrezikun në aktivitetet tona të menaxhimit të aseteve dhe detyrimeve. Për më tepër, në aspektin e menaxhimit të rrezikut, nëpunësit tanë të thesarit menaxhojnë asetet dhe detyrimet duke analizuar vazhdimisht rreziqet e mundshme dhe mundësitë e tregut në kuadër të rregullave të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i aseteve dhe detyrimeve (KAD).

Ekipi i çmimeve të transferimit të fondeve (FTP) menaxhon rrezikun e normës së interesit të bilancit të Bankës dhe pasuritë dhe detyrimet e saj jashtë bilancit në përputhje me metodologjitë e përcaktuara nga Komiteti FICRC dhe komiteti KPD. Për më tepër, menaxhon bilancin dhe të ardhurat e bankës në mënyrë efektive në përputhje me parimet e menaxhimit të rrezikut.

## Ç'ka më tutje?

Në vitin 2016, do ta ruajmë fokusin tonë të fuqishëm për të siguruar ecurinë e qëndrueshme të bankës në të ardhmen.

## 4.8. Burimet njerëzore Politika e burimeve njerëzore

Njerëzit tanë janë pasuria më e rëndësishme e TEB SH.A., pasi janë përkushtimi, dedikimi, aftësitë dhe përpjekjet e tyre që i ndihmojnë Bankës të arrijë objektivat e saja strategjike. Sfidat e vazhdueshme për ekipin e Burimeve Njerëzore janë:

- Të punojnë nga afër me menaxhmentin e bankës për ta siguruar sinergjinë dhe për të krijuar një ambient të rehatshëm pune për punonjësit e bankës;
- Të rekrutojnë dhe mbajë talentet e reja më të mira, dinamike dhe energjike që përshtaten me kulturën dinamike të biznesit tonë. Kërkojmë njerëz që do të kontribuojnë në rritjen e Bankës dhe të cilët janë të aftë të gjenerojnë vlerë të shtuar. Në kthim, ofrojmë mundësi reale të zhvillimit të karrierës dhe pako konkurruese të përfitimeve;
- T'i përkrahë punonjësit në rrugën e tyre të karrierës, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm dhe lëvizshmërisë së brendshme;
- Të zhvillojë dhe menaxhojë sistemin e vlerësimit të performancës; dhe
- T'i japë secilit person mundësi të barabarta gjatë procesit të rekrutimit, transferimit të zhvillimit dhe avancimit.

Në fund të vitit 2015, ekipi i plotë i TEB-it kishte 585 punonjës. Gjatë këtij viti u rekrutuan gjithsej 77 profesionistë të shërbimeve bankare dhe financiare. Në aspektin e lëvizshmërisë, 146 punonjës të TEB-it janë ngritur në pozitë ose kanë marrë sfida të reja në vitin 2015. Kurdo që hapen pozita të reja, gjithmonë u japim njerëzve tanë mundësinë për të lëvizur. Gjatë vitit të raportimit, 27 kolegë të tjerë kanë marrë sfida të reja në lokacione të reja dhe 11 punonjës janë ngritur në pozitë në nivelin e menaxherit.

## Zhvillimi i karrierës

Në vitin 2015, sërish kemi investuar shumë në zhvillimin e vazhdueshëm dhe planifikimin e karrierës së ardhme për punonjësit tanë. Jemi plotësisht të vetëdijshëm se kultura korporative shpërndahe poshtë në organizatë nga niveli

i menaxhmentit. Kjo është arsyeja pse kemi dizajnuar trajnim të avancuar për të gjithë menaxherët (e lartë). Ai përbëhet nga disa module dhe tani formon bazën për trajnimin tonë të menaxhmentit në të ardhmen.

Vëmendje e veçantë u është dhënë punonjësve ekzistues me potencial për t'u bërë menaxherë. Gjatë gjithë vitit, 26 punonjës patën mundësinë të frekuentojnë Qendrën tonë të vlerësimit/Programin e zhvillimit. Nisur në vitin 2014, gjatë vitit 2015 identifikuam dhe caktuam 11 menaxherë të rinj nga ky program dhe tash kemi një grup të menaxherëve të mundshëm për të ardhmen. Besojmë se programe të tilla kontribuojnë për angazhimin e punonjësve, sepse ato rrisin motivimin dhe besimin. Ata e demonstrojnë më tej vlerën e vendosur në ta nga Banka dhe të ardhmen e ndritshme përpara tyre në TEB.

Gjatë vitit 2015, u organizua një varg programesh të vazhdueshme të trajnimit, si brenda bankës ashtu edhe jashtë saj. Këto kurse mbahen nga menaxherët me përvojë dhe nga kompanitë me reputacion shumë të madh të trajnimit. Theks i veçantë i është dhënë trajnimit të detyrueshëm të pajtueshmërisë dhe të gjithë punonjësit aktivë kanë marrë të paktën një kurs trajnimi mbi këtë temë. Në total, janë organizuar 98 kurse të ndryshme dhe kanë marrë pjesë 3.526 punonjës (disa punonjës kanë marrë pjesë në më shumë se një kurs). Për t'u siguruar që zhvillimi i njerëzve tanë është në përputhje me ndryshimet globale në ekonomi dhe teknologji, 158 punonjës tanë kanë udhëtuar jashtë vendit për të marrë pjesë në seminare, panaire, punëtori, konferenca dhe trajnime në vende të ndryshme evropiane, përfshirë Turqinë, Luksemburgu, Mbretërinë e Bashkuar, Francën dhe Shqipërinë.

Edhe trajnimet teknike online përmes platformës së trajnimit në internet të BNP Paribas kanë vazhduar, duke siguruar se

ne përmbushim kërkesat e trajnimit dhe standardet e grupit BNP Paribas.

Për më tepër, me punonjësit që kanë përfunduar me sukses disa kurse trajnimi të aftësive ndërpersonale dhe të trajnimit teknik kemi hapur edhe e-kampusin, platformën tonë të trajnimit online brenda organizatës. Përvoja jonë tregon se kjo platformë është shumë e dobishme për punonjësit dhe, si trajnim është ofruar në gjuhën shqipe për t'u siguruar që e gjithë përmbajtja është e qartë dhe e arritshme për të gjithë punonjësit.

## Inovacionet

Inovacioni është pjesë ADN-së së TEB Sh. A. Jemi të bindur se ky inovacion ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në nivelet e suksesit dhe rritjes të realizuara nga Banka. Gjatë vitit 2015, ekipi i Burimeve Njerëzore ka organizuar një numër të ditëve të nxjerrjes së ideve që synojnë ndarjen dhe promovimin e ideve inovative që e bëjnë TEB-in bankën më të mirë për klientët, si dhe për të rritur sinergjinë ndërmjet ekipeve. Kjo i shton vlerë Bankës, punonjësve tanë dhe çka është më e rëndësishmja, klientëve tanë. Rezultatet e këtyre ngjarjeve të nxjerrjes së ideve janë shumë ide të mëdha dhe jemi në procesin e përkthimit të tyre në projekte të reja.

## Aktivitetet sociale

Duam që punonjësit tanë të jenë të lumtur dhe të motivuar. Aktivitetet sociale janë një pjesë e rëndësishme e këtij motivimi. Gjatë vitit 2015, kemi organizuar evente, festa, takime dhe aktivitete, të cilat u mundësojnë kolegëve të takohen në mënyrë joformale. Këto përfshijnë aktivitete vullnetare që janë plotësisht në përputhje me angazhimin tonë për përgjegjësi korporative.

## Ç'ka më tutje?

Ekipi i Burimeve Njerëzore do të vazhdojë të ofrojë përkrahje të plotë për punonjësit dhe menaxhmentin, si dhe të vendosë prioritetet për rekrutimin dhe mbajtjen e talentëve më të mirë. Fokusi do të mbetet në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve, si dhe mundësive për rrugë të reja të karrierës dhe lëvizshmëri të brendshme.

Ekipi i Burimeve Njerëzore do të organizojë dhe ndjekë vazhdimisht trajnime, për t'u siguruar se zhvillimi i punonjësve tanë është në përputhje me kërkesat dhe standardet e grupit.

## 4.9. Organizimi dhe zhvillimi i proceseve

Nëpërmjet kulturës sonë të korporatës, në të cilën vlera dhe cilësia e shërbimit për klientët është në qendër të çdo gjëje që bëjmë, kemi vazhduar ta shfrytëzojmë forcën tonë duke iu përshtatur më tej modelit tonë të biznesit, që është i fuqishëm dhe që merr parasysh rrezikun.

Si anëtar krenar i dy grupeve të fuqishme financiare ndërkombëtare, jemi duke shfrytëzuar plotësisht ekspertizën e shumëllojshme në mënyrë që TEB të mund të bëhet edhe më i fuqishëm në përballimin e çdo sfide. Kemi vazhduar përpjekjet tona për të përfshirë vlerat dhe strategjitë e grupit në aktivitetet dhe proceset tona të biznesit. Theksi është gjithmonë në pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret, kulturën e fortë të etikës, dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për klientët tanë.

Dokumentet për procedurat dhe politikat janë faktori esencial për komunikimin e vlerave të korporatës dhe standardeve profesionale. Ato shërbejnë si gur themeli për menaxhimin e duhur të aktiviteteve bankare, pajtueshmërinë me kërkesat rregullative dhe ligjore, kontrollin e rreziqeve dhe cilësinë e

shërbimeve të ofruara për klientët. Andaj, gjatë gjithë vitit, banka ka investuar përpjekje të mëdha për të hartuar dhe për të rishikuar procedurat dhe politikat e dokumenteve, duke mbuluar të gjitha aktivitetet e saja, të cilat janë gjithëpërfshirëse, të një cilësie të lartë dhe sigurojnë harmonizimin mes strategjive të biznesit dhe aktiviteteve të biznesit.

Duke pasur kënaqësinë e klientit në zemër të imazhit të brendit që forcon reputacionin tonë, është miratuar në nivel grupi një program gjithëpërfshirës i menaxhimit të cilësisë. Prioritetet janë që kënaqësia e klientit të kthehet në shtyllë qendrore të strategjisë, të sigurohemi se çdo kontakt me bankën ka si rezultatet vlerësim më të madh për bankën nga klientët tanë dhe një imazh më të mirë të profesionit tonë, ta masim nivelin e kënaqësisë së klientit dhe të vendosim objektivat për përmirësim, të dëgjojmë çdo shprehje të pakënaqësisë së klientëve dhe të përpiqemi t'u përgjigjemi shpejt në mënyrën më të përshtatshme, dhe t'i mbrojmë interesat e klientëve duke u sjellë në mënyrë shembullore në çdo kohë dhe duke ofruar produkte dhe shërbime të cilat plotësojnë nevojat e tyre.

Në mjedis dinamik bankar, ku klientët janë të vërshtuar me dhjetëra përgjegjësi ditore, banka vazhdon të përballet me sfidën për të ofruar produkte dhe shërbime të përshtatura që përmbushin nevojat e tyre. Nismat e ndërmarra për zhvillimin dhe efikasitetin operativ i përgjigjen kontrollit dhe optimizojnë proceset për të siguruar operacionet e klientëve dhe, për të përmirësuar efikasitetin dhe shpejtësinë e shërbimeve tona.

Programi i efikasitetit operacional, metodologjia dhe parimet e tij, kanë për qëllim pasurimin e përvojës dhe kënaqësisë së klientit duke ulur ndjeshëm kohëzgjatjen e proceseve, por duke kontribuar edhe në produktivitetin e brendshëm.



## Ç'ka më tutje?

Kur shikojmë përpara, do të vazhdojmë t'i optimizojmë dhe zhvillojmë strukturat organizative themelore dhe infrastrukturën e procesit në përputhje me strategjinë afariste të Bankës. Kënaqësia e klientit dhe efikasiteti operativ do të mbeten dy nga shtysat e krijimit të vlerës.

## 4.10. Teknologjia informative

Viti i raportimit ishte një periudhë e suksesshme për Departamentin TI. Strategjitë tona kryesore kanë qenë rritja e pajtueshmërisë në procesin Njih Klientin Tuaj; zhvillimi i shërbimeve nëpërmjet kanaleve alternative të shpërndarjes; dhe forcimi i infrastrukturës TI të Bankës për t'u siguruar që jemi në gjendje t'i trajtojmë edhe sfidat më të fundit të sigurisë.

### Inovacioni i vazhdueshëm

Në vitin 2015, kemi nisur aplikacionin për shërbime bankare "TebMobile" për klientët tanë individualë. Ai ka qenë në dispozicion fillimisht në IOS dhe synohet të futet për Android në fillim të vitit 2016. TebMobile do të ofrojë më shumë fleksibilitet dhe do të jetë një mjet i përshtatshëm përdorimi për klientët tanë për të trajtuar një gamë shumë të gjerë të aktiviteteve bankare pa pasur nevojë që të vizitohet dega. Gjatë vitit 2016, do të vazhdojmë të rrisim karakteristikat e TebMobile.

Jemi me të vërtetë të kënaqur që aplikacioni ynë TebMobile ka fituar "Çmimin botëror për përvojë" (World Experience Award) në Kongresin Botëror të Përdorshmërisë në vitin 2015.

Me TebMobile, klientët mund t'i përdorin të gjitha shërbimet tona bankare të internetit

thjesht përmes telefonave të tyre smart. Por, ka edhe më shumë.

- Të parët në treg: Smartkey. Metoda e re më e sigurt për qasje në TebMobile dhe shërbimet bankare në internet;
- Integrimi i lexuesit të barkodit për pagesën e faturës;
- Qasja në fushatat bankare;
- Gjetja e bankomatit dhe lokacioneve të degëve në hartë;
- Aplikimi online për kartelat e kreditit dhe kreditë;
- Integrimi me mediat sociale;
- Grafikët e përdorimit të produktit/bilancit; dhe
- Kalendari për pagesat e planifikuara dhe më shumë.

Përveç TebMobile, kemi nisur edhe një numër të konsiderueshëm të karakteristikave dhe mundësive të tjera në ofertën tonë ekzistuese të e-banking. Kemi prezantuar një tipar të ri në disa nga bankomatët tonë: tërheqjen e monedhave. Tani, klientët mund të zgjedhin edhe kartëmonedhat edhe monedhat kur tërheqin fondet. Një tjetër funksionalitet në bankomat është pagesa e borxhit të kartelës së kreditit me anë të depozitimit të parave.

Kemi filluar me kartelën SHE card, produkti i ri i kartelave të kreditit i posaçëm për klientet tona.

Një tjetër tipar i shtuar në shërbimin tonë të kartelave të kreditit është futja e një opsioni me kështu për blerje online, ose përmes terminaleve POS të bankave ndërkombëtare.

Kemi sjellë edhe pajisjet Q-matic për ta përmirësuar menaxhimin e kohës së pritjes në degët tona.

Për klientët tanë të biznesit, tani ofrojmë një funksion të ri të shërbimeve bankare online për menaxhimin e transfertave grupore me një ngarkim të skedarit, pa përpunimin e pagesave individualisht.

Në vitin 2015, gjithashtu kemi vazhduar të integrojmë mundësitë e pagesave për një numër të shërbimeve komunale dhe organizatave të tjera institucionale:

- Integrimi me Doganat për pagesa online;
- Integrimi me KEDS për të siguruar pagesën automatike të faturave të energjisë elektrike; dhe
- Përmirësimi i integritetit të sistemit SMS me IPKO.

## Shërbimet bankare të sigurt dhe infrastruktura e fortë

Ne monitorojnë nga afër të gjitha dobësitë e sigurisë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke marrë masa për ta mbrojtur bankën dhe klientët tanë në përputhje me rrethanat.

Kemi kryer një numër të përmirësimeve në sistemin tonë të prodhimit për të siguruar një infrastrukturë më stabile dhe më të përgjegjshme.

Një ndryshim i vogël praktik, por i rëndësishëm, që kontribuon në angazhimin tonë për mjedisin, është kalimi në shtypjen në të dyja anët në të gjithë printerët tanë. Kjo tani është praktikë standarde në Bankë.

## Ç'ka më tutje?

Punojmë çdo ditë për të ofruar shërbime më të mira dhe produkte inovative për klientët tanë. Kjo strategji do të vazhdojë edhe në vitin 2016. Vitin e ardhshëm, synojmë ta rrisim cilësinë dhe ta përmirësojmë efikasitetin e të gjitha shërbimeve për klientët tanë. Në biznesin tonë të kartelave, planifikojmë të nisim produkte dhe karakteristika të reja. Sa i përket përmirësimeve të harduerit, kemi në plan ta rrisim performancën tonë dhe kapacitetin për të përkrahur nevojat në rritje të tregut dhe të klientëve.

## 4.11. Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale

**"Our reputation among customers, counterparties and our community is one of our most precious assets: maintaining that reputation is an essential condition for the prosperity and sustainability of the Bank. This reputation is based, above all, on the quality and integrity of each of our employees."**

### Siguria e informacionit

Today, Information Security (IS) is a multidisciplinary and transversal issue. IS applies to all kinds of information, whatever its content or format, whose loss, theft, corruption, misuse or disclosure could be harmful to the Bank and its customers. Information security threats are intensifying and come from an ever-increasing range of sources. Legal obligations to meet those threats are being reinforced in the banking sector by national, European and international regulators. Now, with physical security and business continuity, information security will be strategic pillar of our security strategy. During 2015, several projects were implemented to ensure end-to-end availability, resilience and the ability to restore data with a minimum of disruption to business activities. The Bank's training programs include mandatory Information Security training and notifications which ensure employees are aware and equipped to safeguard our customers' and the Bank's assets.


## Mbrojtja e të dhënave personale

Mbrojtja e informacionit të klientëve tanë është edhe prioritet i lartë edhe kërkesë ligjore. Ndërsa teknologjia e re e bën të mundur të nxirren shumë më tepër vlera nga të dhënat tona, ajo gjithashtu na lejon ta përmbushim detyrën tonë të kujdesit në mënyrë më efektive, duke ofruar shërbime të përshtatura. Gjatë ndjekjes së të gjitha këtyre objektivave ne përpiqemi të sigurojmë përputhjen me ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave dhe synojmë të ofrojmë siguri optimale të të dhënave për të gjitha transaksionet, duke respektuar privatësinë e klientit. TEB Sh.A. ka për qëllim të ofrojë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave si në zyrën qendrore ashtu edhe në të gjitha njësitë e biznesit tonë me anë të Politikave të Mbrojtjes së të Dhënave, të cilat janë ndryshuar në vitin 2015. Programet e trajnimit të Bankës përfshijnë trajnimin e detyrueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave. Qëllimi i trajnimit është që të sigurojë një kuptim bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave në mënyrë që të mund të ushtrojmë përgjegjësinë tonë në mbrojtjen e të drejtave dhe privatësisë së individëve gjatë trajtimit të të dhënave personale. Gjatë 2015-ës, 559 punonjës morën pjesë në këtë trajnim.



# Menaxhmenti dhe Qeverisja korporative

## 5.1 Struktura Organizative e TEB Sh.A.



- \* I Raporton Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve
- \*\* I Raporton Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut të Bordit të Drejtorëve

## 5.2. Bordi i Drejtorëve

Musa Erden

Kryetar

Alp Yılmaz

Zëvendës Kryetar

Ayşe Aşardağ

Anëtare

Pascal Alfred J. Gilliard

Anëtar

Sabri Davaz

Anëtar

Tugbay Kumoglu

Anëtar

Mehmet Ozkaya

Anëtar

Ayhan Albeyoğlu

Anëtar (ex-officio)

## Menaxhimi

TEB Sh. A. (Banka/TEB) ka Bordin e Drejtorëve që aktualisht përfshin tetë anëtarë. Të gjithë kanë përvojë të gjerë në shërbime bankare (ju lutemi shihni biografitë e anëtarëve). Bordi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me kërkesat e përcaktuara në statutin e Bankës dhe rregulloret e Bordit të Drejtorëve dhe në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës dhe kërkesat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullatorët. Bordi mbledhet të paktën një herë çdo tre muaj.

## Roli i Bordit të Drejtorëve

Edhe pse detajet janë përcaktuar në nenet 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, detyra kryesore e Bordit është t'i mbikëqyrë aktivitetet financiare dhe afariste të Bankës. Ai është përgjegjës për përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Bankës, politikës afariste të saj duke përfshirë njësitë operative dhe administrative, nën-njësitë dhe funksionet e tyre, pozitat mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese. Për më tepër, Bordi është i ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhmentit të lartë. Bordi i Drejtorëve përcakton dhe krijon strukturën bankare dhe nivelet e ekspozimit të bankës, rishikon dhe miraton rregullimet dhe masat e nevojshme. Për më tepër, Bordi është përgjegjës për miratimin e raportit të menaxhmentit të lartë për aktivitetet e biznesit në bazë të bilancit gjashtëmuor të gjendjes, pasqyrës së fitimit dhe humbjes, bilancit vjetor të gjendjes dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Vendimet e marra nga Bordi kërkojnë shumicën e votave nga anëtarët të cilët ose janë të pranishëm ose votojnë me zyrtarë të autorizuar.

## MUSA ERDEN

### Kryetar

Lindur në Hataj, Turqi në vitin 1950, Musa Erden u diplomua në Akademinë e Shkencave Ekonomike dhe Tregtare të Ankarasë, Departamenti Bankar. E filloi karrierën e tij në bankën Yapi Kredi në vitin 1972. Në vitin 1973 iu bashkua bankës Osmanli, ku deri në vitin 2001 mbajti poste të ndryshme, si Asistent Menaxher i Përgjithshëm, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm (BD/CM), dhe Koordinator. Shërbeu si anëtar i Komitetit të Arbitrazhit të Shoqatës së Bankave Turke nga viti 2002 deri në vitin 2003; si Drejtor i MNG Bank në vitin 2003; si Kryetar i të katër kompanive turistike të Ottoman Structure Construction; dhe si Drejtor i Fondit Ottoman Ltd nga 2006 deri më 2008. Në vitin 2005 iu bashkua TEB Grupit si Auditor i TEB A.Ş. dhe TEB Investime financiare dhe ka shërbyer si konsulent nga viti 2006 deri në emërimin e tij të tanishëm si anëtar i Bordit Ekzekutiv të TEB A.Ş. në vitin 2008. Z. Erden u emërua Kryetar i Bordit të Drejtorëve të TEB Sh.A. në dhjetor të vitit 2010. Nga marsi 2011, ai është edhe ushtrues detyre i Kryetarit të TEB Factoring dhe nga viti 2010 anëtar i Bordit të BNP Paribas Leasing.

## ALP YILMAZ

### Zëvendës Kryetar

Lindur në Stamboll, Turqi në vitin 1965, Alp Yilmaz u diplomua në Fakultetin e Administratës së Biznesit në Universitetin Dokuz Eylul, dhe mori titullin Master në Fakultetin e Shkencave Administrative (Administrim Biznesi) në Universitetin e Stambollit. Karrierën e tij profesionale e filloi si analist financiar në vitin 1991 në Bankën Turke të Zhvillimit Industrial. Ka shërbyer si auditor në Kocbank A.Ş. nga 1992 deri më 1995. Iu bashkua TEB A.Ş. në vitin 1997 dhe ka punuar në Departamente të ndryshme,

duke përfshirë Shitje dhe Marketing, Buxhet dhe Kontroll Financiar dhe Menaxhim të parasë së gatshme. Nga viti 2007 deri në vitin 2012, shërbeu si anëtar i Bordit dhe Drejtor Ekzekutiv i TEB Sh.A. dhe, gjatë qëndrimit të tij ka qenë edhe Zëvendës-Kryetar i Odës Ekonomike të Turqisë dhe Kosovës, anëtar i Bordit të Odës Ekonomike të Francës dhe Kosovës dhe anëtar i Bordit të Shoqatës së Bankierëve të Kosovës. Në janar 2013, ai u largua nga pozita e Drejtorit Ekzekutiv të TEB SH.A. për ta marrë detyrën si Këshilltar i Drejtorit Ekzekutiv të TEB A.S. (Turqi). Nga 11 prilli 2013, u emërua si Nën-Kryetar i TEB Sh.A. dhe kryetar i Komitetit të Kompensimit të TEB SH. A.

## AYSE ASARDAG

### Anëtare e bordit

Lindur në Ankara, Turqi në vitin 1964, Ayse Aşardağ u diplomua në Departamentin e Administrimit të Biznesit të Universitetit Bogaziçi në vitin 1987. U çertifikua si kontabiliste e certifikuar nga Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar të Anglisë dhe Uellsit, ACCA, në vitin 1992. Filloi karrierën e saj profesionale në Price Waterhouse dhe punoi në Njësinë e Auditimit për të dy zyrat, të Stambollit dhe të Londrës nga 1987 deri më 1994. Znj. Aşardağ ishte Ligjëruese e lëndës së Kontabilitetit në Universitetin e Glamorganit nga 1994 deri më 1995. Në vitin 1995, iu bashkua Njësisë për Buxhet dhe Kontroll Financiar të TEB-it deri në vitin 2001. Prej atëherë, ka qenë Drejtoreshë Financiare e Grupit TEB në TEB Holding. Znj. Aşardağ aktualisht shërben si anëtare e Bordit të TEB A.Ş., TEB Factoring dhe TEB Investime, dhe është anëtare e Bordit të Menaxhimit të Aseteve të TEB. Ajo u emërua si Zëvendës-Kryetare e TEB Sh.A. në vitin 2007. Nga dhjetori 2007, znj. Aşardağ është anëtare e Bordit dhe Kryetare e Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.

## PASCAL ALFRED J. GILLIARD

### Anëtar i bordit

Lindur në Leuven, Belgjikë në vitin 1967, Pascal Gilliard u diplomua në degën Inxhinieri e biznesit në Universitetin e Brukselit.

Filloi karrierën e tij profesionale si kandidat për trajnim për menaxhment në Generale Bank në vitin 1990.

Ka mbajtur disa pozita duke përfshirë Menaxher i degës, Menaxher i lartë për marrëdhënie me korporata, dhe Zyrtar për financat e strukturuar deri në bashkimin me kompaninë Fortis. Pastaj, z. Gilliard shërbeu si Zyrtar për shitjen e instrumenteve financiare me të ardhura fikse dhe Bankier i lartë për institucione financiare. Në vitin 2006, u transferua në Hong Kong si kryetar i Grupit të institucioneve financiare të Azisë dhe në vitin 2008 u zgjodh kryetar global i institucioneve financiare jobankare.

Pas bashkimit me BNP Paribas, në vitin 2010 iu bashkua ekipit të Menaxhimit të rrezikut të Grupit në Paris ku veprroi si Zyrtar i lartë për kredi për klientët francezë të CIB-së. Aktualisht mban pozitën e Drejtorit të rrezikut të grupit të TEB-it në Turqi. Që nga viti 2014, është anëtar i Bordit dhe anëtar i Komitetit të auditimit të TEB-it, dhe kryeson Komitetin e menaxhimit të rrezikut.

## SABRI DAVAZ

### Anëtar i bordit

Lindur në Bandirma, Turqi në vitin 1963, Sabri Davaz u diplomua në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Ankarasë dhe mori titullin Master në Ekonomi Financiare nga Universiteti i Bostonit në vitin 2000. Filloi karrierën e tij profesionale në vitin 1985 në nën-sekretariatit të Thesarit në Turqi, ku shërbeu në disa poste deri në vitin 2004, duke

përfshirë Shef i Auditorëve Zyrtarë Bankarë, Zëvendës Kryetar i Bordit të Auditorëve bankarë nën-betim, Auditor nën-betim i bankës. Nga viti 2004 deri më 2009, ishte Zëvendës Kryetar i Rregulloreve Bankare dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Turqisë, gjithashtu duke punuar si konsulent deri në vitin 2011, kur iu bashkua grupit TEB Group si Këshilltar Kryesor i Kryetarit në TEB Holding A.Ş.

Nga marsi i vitit 2012, është anëtar i Bordit të TEB A.Ş. dhe nga shkurti i vitit 2013 shërben si anëtar i Komitetit të Auditimit të TEB A.Ş. Në prill të vitit 2013, u emërua si anëtar i Bordit dhe Zëvendës-kryetar i Komitetit të Auditimit të TEB Sh.A.

## TUGBAY KUMOGLU

### Anëtar i bordit

Lindur në Antalia, Turqi në vitin 1974, Tugbay Kumoglu diplomoi në Fakultetin Ekonomik dhe Shkenca Administrative të Universitetit Gazi. Filloi karrierën e tij profesionale në Garanti Bank si kandidat për trajnim për menaxhment në vitin 1998. Pas mbajtjes së disa pozitave në degët dhe organizatat rajonale në Garanti, u emërua Drejtor i Planifikimit Strategjik të Shërbimeve Bankare për NVM. Posti i tij i fundit ishte në Garanti Bank si menaxher i degës. Iu bashkua TEB Group në vitin 2006 si Menaxher i i Shitjeve Rajonale Evropa 2. Në vitin 2007, u gradua si Drejtor i menaxhimit të shitjeve individuale të TEB. Nga viti 2011, është përgjegjës edhe për menaxhimin e performancës së shërbimeve bankare për individë dhe Star, Financave të konsumatorit, Ekipit për shitje të drejtpërdrejta dhe Pagesave të rrogave të punëtorëve. Nga shkurti i vitit 2013, z. Kumoglu është emëruar si anëtar i Bordit të TEB Sh. A. A.

## Dr. MEHMET OZKAYA

### Anëtar i bordit

Lindur në Konia, Turqi në vitin 1969, Dr Mehmet Ozkaya ka fituar titullin e doktoraturës në Financat Ndërkombëtare (1999) dhe diplomën MBA në Vendim-marrje Financiare (1994) në Universiteti George Washington në Shtetet e Bashkuara, dhe diplomën BSc në Inxhinieri Kompjuterike (1992) në Universiteti Bogazici në Turqi.

Z. Ozkaya ka shpenzuar pjesën e hershme të karrierës së tij në Thesarin e Bankës Botërore në SHBA. Gjatë qëndrimit të tij atje, nga viti 1995 deri më 2006, mbajti poste të ndryshme, duke përfshirë Shef i të ardhurave fikse globale në Investimet e Fondit Pensional (2003-2006), Zyrtar i lartë financiar në tregjet e kapitalit (2000-2002), Zyrtar financiar në financat e strukturuar dhe derivate (1998-1999), dhe Analist financiar i Menaxhimit të aseteve dhe përgjegjësi (1995-1997).

Z. Ozkaya iu bashkua TEB Group në fillim të vitit 2006 si Drejtor për investime i menaxhimit të aseteve të TEB, ku gjithashtu këshilloi Kryetarin dhe KSHE të TEB Group për tregjet globale, ekonomitë ndërkombëtare, dhe menaxhimin e portofolit të investimeve të TEB. Në vitin 2011, u emërua si Drejtor për investime në TEB A.Ş. Që nga prilli i vitit 2013, z. Ozkaya ka shërbyer si anëtar i Bordit dhe Kryetar i Komitetit të MAD-së të TEB Sh.A.

## 5.3. Komitetet

### Komitetet e Bordit të TEB Sh. A.

Në përputhje me Statutin e TEB SH.A. rregulloret dhe kërkesat e Bankës, Bordi ynë ka caktuar një Komitet të Auditimit, një Komitet të menaxhimit të rrezikut, një Komitet të pasurive dhe detyrimeve, një Komitet të Lartë të Kredive dhe një Komitet të Kompensimit (ky i fundit u shfuqizua në mes të vitit 2015) që përbëhen nga anëtarët e Bordit dhe ekspertët e jashtëm. Bordi gjithashtu mund të krijojë komisione ad hoc dhe të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e tyre, aty ku duhet dhe është e përshtatshme. Sipas nenit 22 të Statutit të TEB Sh.A. të datës 24 qershor 2013, komisionet mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve, drejtorëve dhe punonjësve të Bankës, si dhe nga radhët e personave të tjerë jashtë bankës, duke iu nënshtruar kufizimeve në statut. Komitetet nuk duhet të marrin vendime në vend të BD-së ose aksionarëve, por do të veprojnë si këshilltarë për ta.

### Komiteti i auditimit

**Kryetare:** Ayşe Aşardağ

**Zëvendës Kryetar:** Sabri Davaz

**Anëtar:** Pascal Alfred J. Gilliard

**Anëtar:** Nexhat Kryeziu (ekspert i jashtëm)

### Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti i Auditimit ka detyrat dhe përgjegjësitë e qarta që janë të përcaktuara në aktet nënligjore të komiteteve të auditimit dhe janë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe rregulloret. Detyrat e tij përfshijnë:

- Rekomandimin e kontrolleve adekuate të brendshme të kontabilitetit, operative dhe administrative;
- Mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së Bankës me politikat dhe procedurat;
- Kërkesën dhe rishikimin e raporteve nga shefi i departamentit të auditimit të brendshëm të Bankës;
- Rekomandimin e kompensimit për shefin e departamentit të auditimit të brendshëm;
- Monitorimin e pajtueshmërisë me legjislacionin bankar përkatës dhe rregulloret ose kërkesat e aplikueshme;
- Rekomandimin për emërimin e një auditori të jashtëm;
- Monitorimin e performancës së auditorit të jashtëm, rishikimin e raportit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të Bankës dhe raportimin e të gjitha gjetjeve tek Bordi i Drejtorëve;
- Shpërndarjen e opinioneve tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me çdo çështje që i kërkohet atij nga Bordi i Drejtorëve, ose që komisioni dëshiron ta adresojë; dhe
- Miratimin e planit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm të TEB Sh.A.

Komiteti i auditimit mbledhet së paku një herë çdo tre muaj.

## Komiteti i Lartë për Kredi (CRECOM)

**Kryetar:** Jean-Milan Givadinovitch

**Zëvendës Kryetar:** Murat Akşam

**Anëtar:** Alp Yılmaz

**Anëtar:** Haluk Kırçalı

**Anëtar:** Ali İhsan Arıdaşır

### Detyrat dhe përgjegjësitë

Ky komitet është i autorizuar të marrë vendime për kredi për shumat mes 500,000 € dhe 2.5 milion €.

## Komiteti i Menaxhimit të Aseteve dhe Detyrimeve (KAD)

**Kryetar:** Mehmet Ozkaya

**Zëvendës Kryetar:** Ayhan Albeyoglu

**Anëtar:** Alp Yılmaz

**Anëtar:** Pascal Alfred J. Gilliard

**Anëtar:** Tolga Gürdem

**Anëtar:** Arif Bibioğlu

### Detyrat dhe përgjegjësitë

- Monitorimi i tregjeve financiare, duke kontrolluar situatën, lëvizjet dhe ndryshimet në bilancin e gjendjes së bankës dhe marrjen e vendimeve, të gjitha në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Bankës;
- Udhëzimi dhe monitorimi i veprimeve të Departamentit të Thesarit dhe MAD-së në mënyrë të vazhdueshme dhe duke vepruar si organ vendim-marrës, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Komisionit për MAD;
- Mbikëqyrja e menaxhimit të aseteve dhe (borxheve) detyrimeve nga ana e Departamentit të Thesarit dhe MAD-së sipas kriterëve të mëposhtme:
- Sigurimi i respektimit të raporteve të jashtme (rregullative) të përcaktuara nga BQK-ja dhe rregullave të brendshme të përcaktuara nga Bordi ose KAD-i;
- Monitorimi i rezervave së domosdoshme minimale të përcaktuara nga BQK-ja.

Komiteti për asete dhe detyrime mbledhet së paku një herë çdo tre muaj.



## Komiteti i menaxhimit të rrezikut (KMRr)

**Kryetar:** Pascal Alfred J. Gilliard

**Zëvendës Kryetar:** Alp Yilmaz

**Anëtar:** Musa Erden

### Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut është përgjegjës për monitorimin e të gjithë komponentëve të lidhur me rrezikun dhe funksionet që kanë të bëjnë me kreditë, tregun, likuiditetin, çështjet operationale, pajtueshmërinë, reputacionin, çështjet ligjore, mos-shlyerjen e pagesave, mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës dhe rreziqet e tjera.

Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut mbledhet së paku një herë çdo tre muaj.

## Komiteti i kompensimit

**Kryetar:** Alp Yilmaz

**Zëvendës Kryetar:** Ayşe Aşardağ

### Detyrat dhe përgjegjësitë

Përgjegjësitë e këtij komiteti përfshijnë detyrat e mëposhtme:

- Propozimet për zbatimin e Politikës së Bankës për kompensimin për Bordin;
- Propozon një politikë/sistem para Bordit në lidhje me vlerësimin e performancës dhe caktimin e synimeve për menaxhmentin e lartë;
- Propozon për Bordin kriteret e vlerësimit të performancës vjetore dhe afatgjatë dhe objektivat për menaxhmentin e lartë;
- Të paktën një herë në vit (mundësisht në tremujorin e parë të çdo viti), shqyrton dhe miraton vlerësimet përmblendhëse të performancës, objektivat dhe propozimin për pakon kompensuese për menaxhmentin e lartë;
- Jep propozime për Bordin në lidhje me pakon e kompensimit për drejtuesit ekzekutivë; dhe
- Jep raportet mbi kompensimin për Bordin e Drejtorëve në baza vjetore ose sipas kërkesës.

Komiteti i kompensimit mbledhet së paku një herë në vit.

Në takimin e mbajtur më 27 korrik 2015, BD vendosi unanimisht për shpërbërjen e Komitetit të Kompensimit të TEB SH.A. dhe akteve të tij që janë aprovuar më 2 nëntor 2012.

## 5.4. Auditimi i brendshëm

Bordi i Drejtorëve i TEB Sh.A. ka themeluar Departamentin e Auditimit të Brendshëm në shkurt 2013 si një nga komponentët kryesorë në strukturën qeverisëse të Bankës. Para kësaj date, Banka kishte kontraktuar funksionin e saj të auditimit të brendshëm nga Turk Ekonomi Bankasi A.Ş., në bazë të Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (SLA) të nënshkruar në vitin 2008. Banka vazhdon të marrë përkrahje për auditim nga TEB A.Ş. përmes këshillave të auditimit për Departamentin e Auditimit të Brendshëm. Për më tepër, TEB A.Ş. kryen auditime specifike për aktivitetet e caktuara, bazuar në planet e para-përgatitura të auditimit. Departamenti i Auditimit të Brendshëm të Bankës është i pavarur dhe si i tillë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit dhe me iniciativën e vet, nëse e sheh të nevojshme ose të përshtatshme.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm posedon funksion të sigurisë, duke i ndihmuar Bankës për të përmbushur objektivat e saja, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të mjedisit të kontrollit, duke përfshirë proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Është përgjegjësi e Auditimit të Brendshëm që të vlerësojë nëse mjedisi i kontrollit siguron se rreziqet që mund të lindin nga aktivitetet e Bankës menaxhohen në mënyrën që mundëson një nivel të pranueshëm të zbutjes së rrezikut. Aktivitetet e auditimit kryhen nga departamenti i auditimit të brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën një herë në vit duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Secili plan auditimi miratohet nga Komiteti i Auditimit i Bankës. Plani përditësohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar linja të reja biznesi. Në të njëjtën mënyrë, auditori i brendshëm përgjegjës zhvillon

dhe regjistron një plan të fokusuar në rrezik për çdo detyrë të auditimit që analizon pikat e brendshme të rrezikut dhe përfshin objektivat, fushëveprimin, kohën dhe ndarjen e burimeve.

Puna e Departamentit të Auditimit të Brendshëm kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organi drejtues për profesionin e auditimit të brendshëm në të gjithë botën, si dhe me praktikatat e auditimit të TEB Sh. A.

## 5.5. Menaxhimi i rrezikut

TEB Sh. A. ka një qasje gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme sa i përket rrezikut dhe identifikimit e menaxhimit të tij. TEB Sh. A. mat dhe monitoron rrezikun e tregut, likuiditetit, normave të interesit, rrezikun operacional dhe rreziqe të tjera përkatëse (financiare) duke përdorur metodat që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Procesi i menaxhimit të rrezikut është i organizuar sipas strukturës e metodologjive të menaxhimit të rrezikut të TEB A.Ş. dhe BNP Paribas (MRG dhe IRB, respektivisht) dhe favorizon një kulturë të përbashkët të menaxhimit të rrezikut. Procesi është i përbërë nga përkufizimi dhe matjet e rrezikut, themelimi i politikave dhe procedurave të rrezikut, analiza e rrezikut dhe monitorimi, raportimi, si dhe fazat e auditimit. Menaxhmenti i Rrezikut të Grupit (MRG) mbikëqyr procesin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut në kuadër të TEB Group. Departamenti i menaxhimit të rrezikut i TEB SH.A. bashkëpunon me menaxhmentin ekzekutiv për t'u siguruar që rreziqet e marra nga TEB Sh. A. janë në përputhje me politikatat e MRG të TEB A.Ş dhe të IRB të BNPP, si dhe janë në përputhje me objektivat e saja të profitabilitetit dhe vlerësimit të kredive. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut i

raporton çdo muaj Bordit të Drejtorëve, përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, për të gjitha rreziqet relevante financiare, si dhe departamenti i menaxhimit të rrezikut vendos për veprimet zbutëse të atyre rreziqeve.

## Rreziku i kredive

Rreziku i kredive është humbja që mund të ndodhë nëse pala tjetër në marrëdhënie të kredisë dështon, pjesërisht ose tërësisht, për t'i përmbushur detyrimet e saja në kohë. TEB Sh. A. është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nëpërmjet kreditimit të saj, financave tregtare dhe aktiviteteve të thesarit, por rreziku i kredive mund të lindë edhe në rrethana të tjera.

**Zbutja:** Bordi i Drejtorëve ka autoritetin vendimtar në lëshimin e kredive. Në kushte të caktuara, kjo kompetencë u delegohet Komitetit të Lartë të Kredive dhe Drejtorit Ekzekutiv. Ushtrimi i këtyre kompetencave të deleguara monitorohet dhe raportohet rregullisht nga auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut. Ekspozimi primar i TEB SH.A. ndaj rrezikut të kredive lind nëpërmjet kredive dhe paradhënieve të saja për klientët. Shuma e ekspozimit kreditor në këtë drejtim është një funksion i mbajtjes së aseteve në bilancin e gjendjes së konsoliduar. Përqendrimet e rrezikut të kredisë mund të lindin kur një numër i klientëve janë të angazhuar në aktivitete të ngjashme të biznesit, apo aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, ose kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësitë e tyre për t'i përmbushur detyrimet kontraktuese të ndikohen nga ndryshimet ekonomike, politike ose kushtet e tjera. Zyrtarët e portofolit të degës vizitojnë aplikuesit për kredi dhe marrin pasqyrat financiare dhe informacionin në lidhje me aktivitetet dhe planet e investimit të klientit potencial. Përgatitet një propozim për kredi që përmban një koment mbi pozicionin financiar të kompanisë, një analizë

e industrisë, informacion në lidhje me partnerët dhe menaxherët, si dhe referenca nga bankat e tjera dhe kompanitë me të cilat aplikuesi është duke bërë biznes. Ky informacion më pas i dorëzohet Divizionit për Ndarje dhe Monitorim të Kredive që vlerëson besueshmërinë e aplikuesit dhe e përcjell dosjen e kredisë në Komitetin e Lartë Kreditor për vendimmarrje. Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut çdo muaj i vlerëson dhe menaxhon të gjitha rreziqet financiare, përfshirë rrezikun kreditor. Bën vlerësimin e rrezikut të brendshëm në nivel të bankës dhe në nivel të njësive punuese të paktën dy herë në vit. Analiza e nivelit të bankës duhet të shqyrtohet sa herë që ekziston një ndryshim i rëndësishëm në mjedisin operativ që mund të ndikojë në TEB Sh.A. Stres testet e kredive janë një komponent tjetër i rëndësishëm për të kuptuar ndodhitë ose ndryshimet e mundshme në treg që mund të ndikojnë në portofolin e Bankës.

Zhvillimet në treg monitorohen nga afër për ta minimizuar rrezikun kreditor. Raportimi i KJP sektoriale është me rëndësi për të kuptuar lëvizjet në treg. Si rezultat i politikës së kujdesshme të miratuar nga Banka, limiti maksimal i kredisë që mund të marrë një klient mbahet nën kufijtë ligjor, duke minimizuar kështu rrezikun e përqendrimit të kredisë. Limitet e vendosura nga Bordi i Drejtorëve monitorohen dhe raportohen çdo muaj tek Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut. Divizioni për Ndarjen dhe Monitorimin e Kredive bën vlerësime të portofolit të kredisë për Komitetin e kredisë dhe menaxhimit të rrezikut si dhe raporton rastet e rrezikut të lartë dhe kreditë joperformuese. Pasi ofrohet një produkt kreditor, Departamenti për Monitorim të Kredive monitoron aftësinë e klientit për shlyerje dhe mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e kolateralit. Në këtë mënyrë, çdo hua problematike identifikohet në një fazë të hershme. Nëse vlerësimi kreditor dhe/ose cilësia e kolateralit ka ngritur ndonjë dyshim, klienti mandej shqyrtohet dhe monitorohet më hollësisht.

## Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normave të interesit vjen nga mundësia që ndryshimet në normat e interesit të ndikojnë në fitimin e ardhshëm ose vlerën e instrumenteve financiare. Mbrojtja ndaj ndryshimeve në normat e interesit është një prioritet i lartë për TEB Sh. A.

**Zbutja:** Rreziku i normave të interesit përcaktohet duke matur shkallën e ndjeshmërisë së aseteve, detyrimeve dhe vijave jashtë-bilanci. Kjo monitorohet nga afër përmes analizave të hendekut dhe të kohëzgjatjes. Simulimet mbi të hyrat nga interesi kryhen në lidhje me indikatorët e parashikuar ekonomikë të përdorur në buxhetin e Bankës. Efektet e mundshme negative të luhatjes së normës së interesit në pozicionin financiar dhe rrjedhën e parave minimizohen me anë të vendimeve të shpejta. Gjatë përcaktimit të strategjive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të çmimeve, Komiteti i pasurive dhe detyrimeve i TEB SH.A. menaxhon mospërputhjen e maturimit dhe miraton parimin e punës me kufijtë pozitivë të bilancit si dhe politikën e tij të çmimeve.

## Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin humbjet e mundshme që mund t'i pësojë një bankë si pasojë e ekspozimit të vijave të saja të bilancit të gjendjes dhe vijave jashtë-bilancit ndaj rrezikut të normës së interesit, rrezikut të pozicionit të ekuitetit ose rrezikut të kursit të këmbimit, të cilët rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare.

**Zbutja:** Menaxhimi i rrezikut të tregut në TEB Sh.A është dizajnuar që të kontrollojë dhe menaxhojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut, në mënyrë që të optimizohen kthimet duke e ruajtur profilin konservativ të Bankës sa i përket rrezikut.

## Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ndodh kur nuk ka para të mjaftueshme ose rrjedhë të mjaftueshme të parasë për t'i përmbushur kërkesat neto të fondeve në kohën e duhur. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen shpejt me çmime të përshtatshme.

**Zbutja:** Politika e Bankës është të krijojë një strukturë të fondeve që është mjaftueshëm likuide për t'i përmbushur të gjitha llojet e detyrimeve kur ato duhen paguar. Bordi i Drejtorëve rregullisht monitoron dhe përcakton normat e likuiditetit dhe standardet përkatëse për ruajtjen e likuiditetit të lartë gjatë gjithë kohës. TEB Sh. A. ka një sistem efikas sa i përket raportimit me kohë të pozicionit të likuiditetit tek Bordi i Drejtorëve, tek Menaxhmenti i lartë dhe të gjitha njësitë përkatëse. Për më tepër, stres testet e likuiditetit janë një mjet tjetër i rëndësishëm për ta matur likuiditetin e bankës në faza të ndryshme të biznesit.

## Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor përcaktohet si një humbje e mundshme që mund të pësojë një bankë në të gjitha fondet dhe detyrimet e saja në valuta të tjera në rast të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

**Zbutja:** Kufijtë e pozitave të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve monitorohen në baza ditore, si dhe kontrollohen ndryshimet e mundshme në pozitat monetare të Bankës që mund të vijnë si rezultat i transaksioneve rutinore në valuta të huaja.

## Mjaftueshmëria e kapitalit

Qëllimi i bankës është që të sigurohet se ka kapital të mjaftueshëm për t'i mbuluar rreziqet që shoqërojnë punën

e saj. Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut monitoron dhe raporton për normat e mjaftueshmërisë së kapitalit tek Menaxhmenti Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve, përmes Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut. Sipas Ligjit për veprimtarinë bankare dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, ka tre raporte të mjaftueshmërisë që duhet të plotësohen në çdo kohë: Kapitali i klasit të parë në raport me asetet e peshuara me rrezik duhet të jetë të paktën 8%, kapitali total në raport me asetet e peshuara me rrezik duhet të jetë së paku 12% dhe totali i ekuitetit në raport me asetet totale duhet të jetë së paku 7%.

## Rreziku operacional dhe vazhdimësia e punës

Rreziku operacional përkufizohet si rreziku i humbjes që mund të rezultojë nga proceset e brendshme jo adekuate apo jo funksionale, njerëz apo sisteme, apo ngjarje të caktuara të jashtme.

**Zbutja:** Departamenti i menaxhimit të rrezikut në TEB dhe ekipi i tij i dedikuar i rrezikut operacional janë përgjegjës për monitorimin e ndodhive të rrezikut operacional. Ne kemi një sistem të përshtatshëm për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të Bankës për identifikimin efektiv të indikatorëve kryesorë të rrezikut dhe vlerësimin, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut përkatës operacional. Ekipi i rrezikut operacional zbaton metodat për t'u ndihmuar departamenteve të tjera në identifikimin, monitorimin, kontrollimin dhe zbutjen e incidenteve potenciale operationale. Rreziku Operacional ofron trajnime të rrezikut operacional për të gjithë punonjësit, sidomos ata që janë përgjegjës për raportimin e incidenteve ndaj rrezikut operacional dhe Njësine e Vazhdimësisë së Biznesit, dhe kryen vlerësimin e të gjitha

proceseve sa i përket rrezikut operacional si dhe identifikimin e proceseve me rrezik të lartë. Vazhdimësia e biznesit, pavarësisht nga lloji dhe arsyeja e saj, përbëhet tërësisht nga planet që sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike të punës së bankës në rast të ndërprerjes së punës ose në rast fatkeqësish. Njësia e Rrezikut Operacional dhe Vazhdimësisë së Biznesit angazhohet vazhdimisht në përkufizimin, matjen dhe raportimin e rrezikut tek Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut. Rezultatet e Njësise për Rrezikun operacional dhe Vazhdimësinë e Biznesit shqyrtohen dhe vlerësohen çdo muaj në Bordin e Drejtorëve përmes Komisionit për Menaxhimin e Rrezikut.

## 5.6. Pajtueshmëria dhe kontrolli i brendshëm

Jemi të përkushtuar për aktivitete bankare të përgjegjshme dhe për të vepruar me integritet dhe përgjegjësi në çdo gjë që bëjmë. Në TEB, besojmë se mënyra si kryejmë afarizmin është po aq e rëndësishme sa qëndrueshmëria e rritjes së biznesit tonë për krijimin e vlerës për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë. Nënkuptohe se respektimi i ligjeve dhe rregulloreve, standardeve dhe udhëzimeve më të larta ndërkombëtare është pjesë e identitetit tonë dhe formon themelin e mënyrës sonë të biznesit.

Në të njëjtën kohë, kemi vendosur standarde të larta të integritetit të biznesit dhe sjelljes etike me qëllim rritjen e efektivitetit të kornizës së pajtueshmërisë. Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të vazhdueshme në kërkesat rregullative në Kosovë dhe në nivelin e Grupit BNP Paribas, ku menaxhimi i pajtueshmërisë po kthehet në prioritet kryesor. Këtë vit, gjatë 2015-ës jemi



ballafaquar me shumë sfida, por vlerësojmë rritjen e rëndësisë, vetëdijes dhe zbatimit në fushën e pajtueshmërisë. Fryma jonë ekipore, përkushtimi dhe përmirësimi i qëndrueshëm i efikasitetit tonë kanë të gjitha për qëllim ruajtjen e integritetit të institucionit tonë financiar. Presim që punonjësit tanë të veprojnë me ndershmëri, me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë dhe profesionale, në shërbim të interesave më të mira të klientëve dhe duke respektuar integritetin e tregjeve. Kodi ynë i sjelljes, i përbërë nga vlerat, sjellja dhe kërkesat tona etike në biznes, formon bazën e mënyrës së sjelljes së punonjësve tanë me kolegët dhe klientët tanë, partnerët afaristë, aksionarët dhe autoritetet. Kodi i mirësjelljes përfshin dispozitat etike në biznes që kanë për qëllim menaxhimin e konfliktit të interesit, parandalimin e abuzimit të tregut, luftimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera ekonomike. Jemi të përkushtuar për të respektuar ligjet e rrepta, rregulloret dhe udhëzimet për ta luftuar shpëlarjen e parave, financimin e terrorizmit dhe për ta parandaluar shkeljen e sanksioneve financiare ndërkombëtare. I analizojmë klientët tanë dhe transaksionet e tyre për të parandaluar që emri ynë dhe produktet dhe shërbimet tona të keqpërdoren për qëllime të tilla. Kjo mund të shihet në numrin e rritur të punonjësve që punojnë në Departamentin tonë të pajtueshmërisë, si dhe në zbatimin e mjeteve të avancuara lidhur me KSHP/LFT dhe sanksionet financiare ndërkombëtare. Për këtë qëllim, zbatojmë masa të përpikta të përkrahura nga sistemet automatike të monitorimit dhe procesin e shqyrtimit “njihe klientin tënd” (NJKT). Procesi ynë i rishikimit NJKT shërben për të përditësuar informacionin për të menaxhuar rreziqet e KSHP-së që mund të paraqiten për shkak të ofrimit të shërbimit për një klient ekzistues. Procesi është në formën e rishikimeve të rregullta, sipas procedurave të përcaktuara dhe përfshin vlerësimin e njerëzve apo subjekteve

që janë pronarët e fundit përfitues. Masat preventive dhe zbatimi i kontrolleve të hollësishme na ndihmojnë të respektojmë rreptësisht ligjet dhe rregulloret si dhe politikat e procedurat e përshtatura të BNP Paribas Group. Prandaj, në vitin 2015 kemi realizuar disa projekte të rëndësishme për të forcuar infrastrukturën tonë të TI-së dhe qasjet ndër-funksionale ndaj etikës së punës, për parandalimin e shpëlarjes së parave/financimit të terrorizmit/shkeljes së sanksioneve financiare ndërkombëtare dhe konfliktit të interesit, dhe do të vazhdojmë të punojmë në projekte të ngjashme në të ardhmen. Me qëllim të promovimit të programit tonë të pajtueshmërisë dhe për të siguruar ndërgjegjësimin dhe respektimin nga punonjësit tanë, kemi zgjeruar programin tonë të trajnimit për të përfshirë mësimin elektronik (e-learning) dhe module të veçanta për temat kryesore të pajtueshmërisë.

Modulet janë në dispozicion për të gjithë punonjësit dhe mund të përshtaten me nevojat e linjave tona të biznesit në përputhje me kërkesat specifike të punës. Ato gjithashtu plotësojnë gamën e gjerë të programeve të trajnimit në vend që adresojnë tema të pajtueshmërisë. Shumica e disiplinave të mbuluara nga modulet profesionale janë të bazuara në konceptet e përbashkëta të transparencës. Departamenti ynë i Pajtueshmërisë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit. Qëllimi i tij është të menaxhojë rrezikun e pajtueshmërisë në mënyrë të duhur për t'u siguruar që aktivitetet bankare janë në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret përkatëse.

## Kontrolli i Brendshëm

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm siguron mbizotërimin e një mjedisi të shëndoshë kontrolli të brendshëm në TEB Sh.A. Ai merret me koordinimin thelbësor

dhe garanton se aktivitetet përkatëse kryhen rregullisht, në mënyrë efikase, efektive dhe në përputhje me strategjinë e menaxhmentit dhe politikat e Bankës, si dhe me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Pas ndryshimeve organizative gjatë vitit, funksionet e kontrollit të brendshëm dhe rrezikut operacional tani janë të strukturuar veçmas. Brenda fushëveprimit të kontrollit të brendshëm, kontrollet e përditshme, javore, kontrollet mujore dhe tremujore të aktiviteteve kritike në degë dhe departamentet e zyrës qendrore kryhen nga njësia e kontrollit të degës dhe njësia qendrore e kontrollit.

Kontrolluesi kryen kontrollet e tij/saj në pajtim me listat e kontrollit të cilat janë të përgatitura paraprakisht dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe të jashtme. Listat e kontrollit rishikohen nëse ndodhin ndryshime në rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe/ose të jashtme.

#### **Pikat e kontrollit në listat e kontrollit përdoren për:**

- Verifikimin e respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe pajtueshmërinë e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore dhe respektimin e tyre;
- Kontributin për ruajtjen e pasurive;
- Vlerësimin e mjaftueshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të përditshme; dhe
- Kontributin në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të lidhura me aktivitetet afariste dhe të propozuara, aktuale dhe të ardhme të organizatës, duke përfshirë produktet e reja.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm i raporton çdo tre muaj direkt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të Auditimit.

# Raporti i Auditorit



**TEB SH.A.**

**Pasqyrat Financiare të përgatitura në përputhje me  
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

**(së bashku me raportin e audituesve të pavarur)**

**PERMBAJTJA**

**FAQE**

**RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR**

**PASQYRAT FINANCIARE**

|                                                                              |               |
|------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| <b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>                                        | <b>1</b>      |
| <b>PASQYRA E FITIMIT HUMBJES DHE TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE</b> | <b>2</b>      |
| <b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL</b>                                      | <b>3</b>      |
| <b>PASQYRA E RRJEDHES SE PARASE</b>                                          | <b>4</b>      |
| <b>SHENIME LIDHUR ME PASQYRAT FINANCIARE</b>                                 | <b>5 - 54</b> |



**KPMG Albania Shpk Kosovo Branch**  
6, Pashko Vasa Street  
Pristina, Kosovo

Telephone +381(38)246771  
Telefax +381(38)610772  
E-mail al-kosovo@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

*Raporti në gjuhën Angleze është version original/zyrtar, ky version në gjuhën shqipe është vetëm për qëllim informimi.*

## Raporti i Audituesve të Pavarur

Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të  
TEB SHA

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të TEB SHA ("Banka") të cilat përbëhen nga pasqyrat e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrat e fitimit ose humbjeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ndryshimeve në kapital dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përbëhen nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe të shënime të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm i cili, të tillë sic drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi ynë, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



*Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2015, dhe rezultatin e saj financiar dhe flukset e saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch*

KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch

6 Pashko Vasa Street


Pristina, Kosovo


18 mars 2016

**TEB SH.A.**  
**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor  
Në mijë EUR

|                                                   | Shënime | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---------------------------------------------------|---------|-----------------|-----------------|
| <b>AKTIVET</b>                                    |         |                 |                 |
| Paraja e gatshme dhe balanca me bankat            | 5       | 72,876          | 67,893          |
| Kredi dhe paradhënie për bankat                   |         | 5,004           | -               |
| Kredi dhe paradhënie për klientët                 | 6       | 313,744         | 287,025         |
| Aktivet financiare të vlefshme për shitje         | 8       | 10,288          | 7,277           |
| Prona dhe paisjet                                 | 11      | 3,750           | 4,274           |
| Aktivet e patrupëzuara                            | 12      | 1,723           | 830             |
| Aktive të tjera financiare                        | 9       | 1,920           | 1,569           |
| Aktive nga tatimi i shtyer                        | 24      | 90              | 71              |
| Aktive të tjera                                   | 10      | 1,181           | 404             |
| <b>Total i aktiveve</b>                           |         | <b>410,576</b>  | <b>369,343</b>  |
| <b>DETYRIMET</b>                                  |         |                 |                 |
| Detyrime ndaj klientëve                           | 13      | 342,878         | 314,353         |
| Detyrime të tjera financiare                      | 14      | 2,166           | 2,380           |
| Detyrime të tjera                                 | 15      | 494             | 506             |
| Detyrime për tatimin mbi fitimin                  |         | 1,072           | 596             |
| Huamarrjet                                        | 16      | 10,975          | 15,853          |
| <b>Totali i detyrimeve</b>                        |         | <b>357,585</b>  | <b>333,688</b>  |
| <b>KAPITALI AKSIONAR</b>                          |         |                 |                 |
| Kapitali aksionar                                 | 17      | 24,000          | 24,000          |
| Fitimet e mbajtura                                |         | 28,991          | 11,655          |
| <b>Totali i kapitalit aksionar</b>                |         | <b>52,991</b>   | <b>35,655</b>   |
| <b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar</b> |         | <b>410,576</b>  | <b>369,343</b>  |

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Menaxhmenti ekzekutiv më 18 mars 2016 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

  
Z. Ayhan Albeyoglu  
Drejtori Menaxhues

  
Z. Dukagjin Shylemaja  
Zevendes Drejtori Menaxhues

Shënimet nga faqja 5 deri ne 54 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

**TEB SH.A.****Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

|                                                   | Shënime | Për vitin e<br>mbyllur më<br>31 dhjetor 2015 | Për vitin e<br>mbyllur më<br>31 dhjetor 2014 |
|---------------------------------------------------|---------|----------------------------------------------|----------------------------------------------|
| Të ardhurat nga interesi                          | 18      | 32,843                                       | 34,167                                       |
| Shpenzimet e interesit                            | 19      | (2,500)                                      | (5,825)                                      |
| <b>Të ardhurat neto nga interesi</b>              |         | <b>30,343</b>                                | <b>28,342</b>                                |
| Të ardhurat nga tarifa dhe komisione              | 20      | 7,904                                        | 7,279                                        |
| Shpenzimet për tarifa dhe komisione               | 21      | (1,554)                                      | (1,517)                                      |
| <b>Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione</b>  |         | <b>6,350</b>                                 | <b>5,762</b>                                 |
| Fitimi neto nga kurset e kembimit                 |         | 326                                          | 250                                          |
| Të ardhurat e tjera operative                     |         | 22                                           | 53                                           |
| Provizionet për humbjet e kredive                 | 6       | (1,099)                                      | (8,396)                                      |
| Humbje të tjera nga rënia në vlerë dhe provizione | 7       | (226)                                        | 217                                          |
| Shpenzimet e personelit                           | 22      | (7,005)                                      | (6,908)                                      |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi                        |         | (2,334)                                      | (1,819)                                      |
| Shpenzimet administrative dhe të tjera            | 23      | (6,997)                                      | (7,170)                                      |
|                                                   |         | <b>(17,313)</b>                              | <b>(23,773)</b>                              |
| <b>Fitimi para tatimit</b>                        |         | <b>19,380</b>                                | <b>10,331</b>                                |
| Shpenzimet e tatimit në fitim                     | 24      | (2,063)                                      | (1,141)                                      |
| Tatimi ne fitim i shtyrë                          |         | 19                                           | 71                                           |
| <b>Fitimi neto për vitin</b>                      |         | <b>17,336</b>                                | <b>9,261</b>                                 |
| Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse             |         | -                                            | -                                            |
| <b>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse</b>       |         | <b>17,336</b>                                | <b>9,261</b>                                 |

Shënimet nga faqja 5 deri në 54 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

**TEB SH.A.****Pasqyra e ndryshimeve në kapital****Për vitin që mbyllet më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

|                                                | <b>Kapitali aksionar</b> | <b>Fitimet e mbajtura</b> | <b>Totali</b> |
|------------------------------------------------|--------------------------|---------------------------|---------------|
| Gjendja më 1 janar 2014                        | <b>24,000</b>            | <b>2,394</b>              | <b>26,394</b> |
| Kapital i nënshkruar                           | -                        | -                         | -             |
| Fitimi neto i vitit                            | -                        | 9,261                     | 9,261         |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse          | -                        | -                         | -             |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b> | <b>-</b>                 | <b>9,261</b>              | <b>9,261</b>  |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2014</b>              | <b>24,000</b>            | <b>11,655</b>             | <b>35,655</b> |
| Kapital i nënshkruar                           | -                        | -                         | -             |
| Fitimi neto i vitit                            | -                        | 17,336                    | 17,336        |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse          | -                        | -                         | -             |
| <b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b> | <b>-</b>                 | <b>17,336</b>             | <b>17,336</b> |
| <b>Gjendja më 31 dhjetor 2015</b>              | <b>24,000</b>            | <b>28,991</b>             | <b>52,991</b> |

Shënimet nga faqja 5 deri në 54 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

**TEB SH.A.****Pasqyra e rrjedhjes së parasë****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

|                                                               | <b>Shënime</b> | <b>2015</b>     | <b>2014</b>     |
|---------------------------------------------------------------|----------------|-----------------|-----------------|
| <b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative</b>            |                |                 |                 |
| <b>Fitimi i periudhës</b>                                     |                | <b>17,336</b>   | <b>9,261</b>    |
| Zhvlerësimi                                                   | 11             | 1,229           | 1,280           |
| Amortizimi                                                    | 12             | 1,105           | 539             |
| Provizionet për humbjet e kredive                             | 6,7            | 1,325           | 8,179           |
| Fitimi neto nga kurset e kembimit                             |                | 326             | 250             |
| Humbja nga shitja e pasurive                                  |                | 6               | 32              |
| Humbja nga fshirja e pronave dhe paisjeve                     |                | (5)             | (33)            |
| Të ardhurat nga interesi                                      | 18             | (32,843)        | (34,167)        |
| Shpenzimet e interesit                                        | 19             | 2,500           | 5,825           |
| Shpenzime tatimi                                              |                | 2,044           | 1,070           |
|                                                               |                | <b>(6,977)</b>  | <b>(7,764)</b>  |
| Pakesime/ (shtesa) ne balancat me BQK                         |                | (1,658)         | 531             |
| Shtesa ne kredite dhe paradhëniet me klientët                 |                | (28,039)        | (29,432)        |
| Shtesa ne pasuri të tjera financiare                          |                | (351)           | (224)           |
| (Shtesa)/ Pakesime ne pasuri të tjera                         |                | (777)           | (262)           |
| Shtesa/ (Pakesime) ne detyrime ndaj klientëve                 |                | 27,046          | (14,196)        |
| (Pakesime)/ Shtesa ne detyrime të tjera financiare            |                | (214)           | 924             |
| Pakesime ne detyrime të tjera                                 |                | (12)            | (275)           |
|                                                               |                | <b>(10,982)</b> | <b>(50,698)</b> |
| Interesi i pranuar                                            |                | 32,502          | 34,326          |
| Interesi i paguar                                             |                | (1,603)         | (4,429)         |
| Tatimet e paguara                                             |                | (991)           | (926)           |
| <b>Rrjedhja hyrese/ (dalese) nga aktivitetet operative</b>    |                | <b>18,926</b>   | <b>(21,727)</b> |
| Blerje të pasurive dhe paisjeve                               |                | (710)           | (1,135)         |
| Blerje të aktiveve të patrupëzuara                            |                | (1,998)         | (694)           |
| Blerje e aktiveve financiare të vlefshme për shitje           |                | (3,011)         | (6,452)         |
| <b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>       |                | <b>(5,719)</b>  | <b>(8,281)</b>  |
| <b>Rrjedhja e parave nga aktivitetet financuese</b>           |                |                 |                 |
| Ripagesat e huave                                             |                | (4,878)         | (469)           |
| <b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese</b>       |                | <b>(4,878)</b>  | <b>(469)</b>    |
| <b>Rritja/(pakësimi) neto e parasë dhe ekuivalentët e saj</b> |                | <b>8,329</b>    | <b>(30,477)</b> |
| Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 1 janar            |                | 39,091          | 69,568          |
| <b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor</b>  | <b>5.1</b>     | <b>47,420</b>   | <b>39,091</b>   |

Shënimet nga faqja 5 deri në 54 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.



## **TEB SH.A.**

### **Shënimet e pasqyrave financiare**

#### **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

---

Në mijë EUR

#### **1. Entiteti raportues**

Ne përputhje me rregulloret e Bankes Qendrore te Kosoves ("BQK"), TEB SH.A. ("Banka") ka marre licencen per aktivitetet bankare me 19 dhjetor 2007 dhe ka filluar operacionet gjate janarit 2008. Selia e regjistruar e Bankës është e vendosur në Prishtinë, Kosovë. Banka operon si banke komerciale dhe e kursimeve per te gjitha kategorite e klienteve brenda Kosoves, permes nje rrjeti prej 26 (2014: 25) degeve ne Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Banka kontrollohet nga TEB Holding e regjistruar ne Turqi (Prind), e cila zotëron 100% te aksioneve te rregullta si me 31 dhjetor 2015 (2014: 100% aksioneve te rregullta). Aksionaret e TEB Holding jane BNP Paribas dhe Çolakoğlu Group, secili nga ata zoteron 50% te aksioneve.

Selia e regjistruar e Bankës është e vendosur ne rrugen Agim Ramadani, Nr. 15, 10000 Pristine, Kosovë.

#### **2. Baza kontabël**

##### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të), të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Detajet mbi politikat kontabël të Bankës dhe ndryshimet e tyre gjatë vitit, paraqiten në Shënimin 3.

##### **2.2. Baza e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje, të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

##### **2.3. Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Këto pasqyra financiare paraqiten në EUR, e cila përbën dhe monedhën funksionale të Bankës. Të gjitha shumatat janë rrumbullakuar në mijëshen më të afërt, përveç kur tregohet ndryshe.

#### **3. Politika të rëndësishme kontabël**

##### **3.1. Shpenzime dhe te ardhura nga interesi**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme, përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar ose pasivit financiar (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër) deri në vlerën kontabël të aktivitetit financiar ose pasivit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATP) përfshijnë:

- interesi nga aktive ose detyrime financiare matur me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv; dhe
- Interesi nga investime të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

##### **3.2. Komisione dhe tarifa**

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv (shih (3.1)).

Tarifa dhe komisione te tjera njihen ne momentin kur kryhen shërbimet qe lidhen me to.

## **TEB SH.A.**

### **Shënimet e pasqyrave financiare**

#### **Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

---

Në mijë EUR

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.3. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare**

##### ***Njohja***

Aktivët financiarë ose detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo lëshimin, për zera të mbajtur jo sipas vlerës së drejte përmes fitimit ose humbjes.

##### ***Klasifikimi***

Aktivët financiarë klasifikohen në një nga keto kategori: të vlefshme për shitje dhe llogari të arkëtueshme.

Klasifikimi I aktiveve financiare përcaktohet në matjen fillestare, varet nga karakteristikat e instrumentit dhe qëllimet e menaxhmentit.

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare (përveç garancive dhe angazhimeve për hua) si të matura me kosto të amortizuar.

##### ***Matja***

Aktivët financiarë fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kostot e transaksionit, nëse ka. Kreditë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kostot e transaksionit, nëse ka. Pas matjes fillestare këto me vone maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kosto e amortizuar kalkulohet duke përdorur metodën e interesit efektiv. Premiumet dhe zbritjet, përfshirë kostot e transaksionit, përfshijnë vlerën bertese të instrumentit përkatës dhe amortizohen në bazë të normës efektive të interesit të instrumentit, kur është e aplikueshme.

Metoda e interesit efektiv është një metode e kalkulimit të koston të amortizuar të një aktivi financiar dhe e alokimit të të ardhurave nga interesat përgjatë një periudhe relevante. Norma e interesit efektiv është norma që saktësisht i skanton flukset e ardhshme të pasqyrës të parashikuara (përfshirë të gjitha tarifat në pikat e ofruara dhe paguara që janë pjesë integrale të normës efektive të interesit, kostot e transaksionit dhe premiumet dhe zbritjet tjera) përgjatë jetëgjatësisë së pritur të aktivit financiar, ose, ku është me e përshtatshme, një periudhe me të shkurtër.

##### ***Çregjistrimi***

Aktivi financiar çregjistrohet kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur ato transferon dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim. Transaksioni trajtohet si transfer i një aktivi financiar kur kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar. Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

##### ***Kompensimi***

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompesuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF.

##### ***Matja me kosto të amortizuar***

‘Kostoja e amortizuar’ e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

##### ***Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj***

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedha dhe kartmonedha në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuar në përdorim dhe aktive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në mijë EUR

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**3.3. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

***Aktivët financiarë të vlefshme për shitje***

Aktivët financiarë të vlefshme për shitje maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit. Me pas njohjes fillestare maten me vlere të drejte. Aktivët financiarë të vlefshme për shitje përbëhen nga investime borxhi. Fitimet dhe humbjet e tjera në vlerën e drejtë, për aktivët financiarë të vlefshme që njihen në ATP dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda kapitalit.

Te ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit në aktivët monetare të klasifikuara aktivët financiarë të vlefshme për shitje njohin në fitim ose humbje.

***Kreditë dhe parathëniet***

Kreditë dhe parathëniet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe parathëniet për bankat dhe për klientet klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme.

Kreditë dhe parathëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit, dhe në vijim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe minus ndonjë zbritje (përmes përdorimit të llogarisë së lejimit) për rënien në vlere ose pa mbledhshmerine.

***Zhvlerësimi i kredive dhe parathënieve***

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivët financiarë ose një grup aktivesh financiarë të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Nëse evidenca e tillë ekziston, vlera e kthyeshme e parashikuar dhe ndonjë humbje nga rënia në vlere nga ai aktiv përcaktohet, bazuar në vlerën e tashme neto të flukseve të ardhshme të para, dhe njihet për diferencën në mes të vlerës së kthyeshme dhe vlerës bartëse si vijon:

Kreditë dhe parathëniet ndaj klientëve raportohen me koston e amortizuar neto nga provisionet (lejimet) për të reflektuar vlerat e parashikuara të kthyeshme.

Një provizion për rrezikun kreditor për rënie në vlere të kredive vendoset nëse ka evidencë objektive që Banka nuk do të mund të mbledhë shumat sipas kushteve origjinale të kontratës.

Shuma e një provizionit është diferenca në mes të vlerës bartëse dhe vlerës së parashikuar të kthyeshme, e kalkuluar si vlera e tashme e flukseve montare të pritshme përfshirë dhe shumat e kthyeshme nga garancionet dhe kolateralët, e skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit. Interesi në aktivët e rena në vlere vazhdon të njihet përmes skontimit të provizioneve.

Lejimet janë bërë kundrejt vlerës bartëse të kredive dhe parathënieve dhe identifikohen si të zhvlerësuara në bazë të shqyrtimeve të rregullta të balanceve të papaguara për të reduktuar këto hua dhe parathënie në vlerën e tyre të kthyeshme. Lejimi për zhvlerësimin e kredive përfshin edhe humbjet kur ka evidencë objektive që humbjet e mundshme janë të pranishme në komponentët e portofolit të kredisë në datën e bilancit. Këto janë vlerësuar në bazë të modeleve historike të humbjeve në çdo komponent dhe rangimi i kredive i caktuar për huamarrësit reflektojnë mjedisin aktual ekonomik në të cilin veprojnë huamarrësit.

Klasifikimi i kredive është i bazuar mbi një rishikim të të gjithë faktorëve të kredisë, përmbajnë dobësi që janë të natyrshme në një kredi, ose në qoftë se ka një probabilitet që një pjesë e shumës së kredisë nuk do të paguhet. Kriteret e përdorura nga Banka për të vendosur nëse ka evidencë objektive që aktivët financiarë janë të zhvlerësuara përfshijnë:

- Mospagim i detyrimeve kontraktuale të principalit (kryegjësë) ose interesit;
- Vështirësi në flukset e rrjedhjes së parasë të përjetuara nga huamarrësi;
- Shkelja e kontratave ose kushteve të kredisë;
- Fillimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut; dhe
- Përkeqësimi i rangimit kreditor të leshuesit në nivelin e pranueshem.

Në mijë EUR

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****3.3. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)*****Zhvlerësimi i aktiveve financiare te vlefshme per shitje***

Banka vlerëson në cdo datë raportimi nëse ka dëshmi objektive se një aktiv financiar i vlefshme për shitje është zhvlerësuar. Në rastin e investimeve të kapitalit të klasifikuara si të vlefshme për shitje, një rënie e rëndësishme e zgjatur në kohë e vlerës se drejte të investimit nën koston e tij konsiderohet një evidence objektive për zhvlerësim. Nëse ekzistojnë dëshmi të tilla, humbja e akumuluar largohet nga pasqyra e të ardhurave të tjera gjithëpërshirëse dhe njihet në fitim dhe humbje. Zhvlerësimet që njihen në fitim ose humbje për investimet e kapitalit nuk mund të kthehen përmes fitimit ose humbjes. Rritja e mëvonshme në vlerën e drejtë, pas zhvlerësimit njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërshirëse.

**3.4. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedha të huaja janë kthyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla nga kthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të denominuara në valuta të huaja njihen në fitim ose humbje (si neto fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit).

Zërat jo monetar maten në kushte të koston historike në valutën e huaj dhe nuk kthehen.

**3.5. Prona dhe pajisje**

Prona dhe pajisje maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Cdo vit, Banka vlerëson nëse ka tregues që aktivet mund të jenë zhvlerësuar. Nëse ka të dhëna të tilla, vlerësohet vlerat që pritet të rikuperohet. Vlera e vlerësuar e rikuperueshme është më e madhe se vlera e drejtë e aktivit minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Kur vlera bartese e një aktivi është më e madhe se vlera e rikuperueshme, ai shlyhet deri në shumën e rikuperueshme dhe dallimi është i ngarkuar në fitim dhe humbje.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e pronës dhe pajisjeve janë të përcaktohet duke iu referuar vlerës kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën. Riparimet dhe mirëmbajtja ngarkohen në fitim ose humbje kur shpenzimet janë kryer.

Zhvlerësimi ngarkohet duke përdorur metodën lineare, gjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale. Për shtesat zhvlerësimi është ngarkuar pas muajit të blerjes ndërsa për shitjet deri në muajin shitjes. Zhvlerësimi nuk fillon derisa pasuritë të jenë në dispozicion për përdorim.

Normat vjetore të zhvlerësimit të përdorura për secilën kategori të pronës dhe pajisjeve janë si vijim:

**Kategoria e aktivitet****Normat e zhvlerësimit të përdorur**

Përmirësimet e pronës së dhënë me qira

5 vite ose afati i qirase, cila do që është me i

shkurter

Mobilje dhe pajisje zyre

3-5 vite

Kompjuter dhe pajisjet e lidhura

3-5 vite

Veturat

5 vite

**3.6. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara**

Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara janë matur fillimisht me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, kur kerkohet. Amortizimi njihet me metodën lineare me një normë vjetore prej 20 %.

Shpenzimet e mëvonshme të kapitalizuara mbi aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivet e veçanta të cilave ai i referohet. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin. Amortizimi nuk fillon derisa pasuritë janë në dispozicion për përdorim.

Në mijë EUR

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.7. Aktivët afatgjatë të mbajtura për shitje**

Aktivët afatgjatë të mbajtura për shitje perbehen nga aktive financiare dhe jo financiare të marra nga banka për të shlyer kreditë e vonuara. Aktivët e tilla njihen fillimisht me vlerën e drejtë, kur merren dhe përfshihen në prona dhe pajisjet, mjetet e tjera financiare ose inventarët brenda aktiveve të tjera në varësi të natyrës së tyre dhe synimit të Bankës në lidhje me kthimin e këtyre aseteve, dhe më pas të ri-matën dhe llogariten në përputhje me politikat kontabël për këto kategori të aktiveve.

#### **3.8. Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Një humbje nga zhvlerësimi njihet kur vlera e mbetur e aktivit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e larta në mes të vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim e një aktivi është vlera aktuale e flukseve monetare të ardhshme të pritshme nga përdorimi i vazhdueshëm i një aktivi dhe nga shitja e tij.

#### **3.9. Detyrime ndaj bankave**

Detyrime ndaj bankave regjistrohen kur paratë ose pasuritë e tjera i jepen në avancë bankës nga bankat tjera. Detyrimet jo-derivative mbahen me kosto të amortizuara.

#### **3.10. Detyrime ndaj klientëve**

Detyrime ndaj klientëve janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, klientëve shtetërore apo korporatave dhe mbahen me kosto të amortizuara.

#### **3.11. Huamarrjet**

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit të bëra. Huamarrjet më pas paraqiten me kosto të amortizuara. Çdo interes apo tarifë të kryer me fondet e huazuara shpenzohet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe të paraqitet në fitim dhe humbje për periudhën.

Kostot e huamarrjes që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e një aktivi të kualifikuar janë të njohura si pjesë e kostos së këtij aktivi. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen si një shpenzim në periudhën në të cilën ato janë shkaktuar.

#### **3.12. Tatimi**

Tatimi aktual në të ardhura llogaritet në bazë të rregulloreve në fuqi në Kosovë për tatimin mbi të ardhurat, duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e bilancit. Në fuqi nga 1 janar 2010, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 03 / L-162 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave". Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përmban tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë. Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të tatueshëm që pritët për vitin duke përdorur normat tatimore të zbatuara në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi i raportuar në fitim dhe humbje sepse përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet tjera dhe më tej përjashton zërat që nuk janë të tatueshme ose të zbritshme. Tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi në fitim i shtyrë llogaritet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit të gjendjes për diferencat e përkohshme që dalin në mes të bazës tatimore e aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Aktivit tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktivit tatimor i shtyrë zvogëlohet deri në masën që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Aktivët dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat tatimore që pritët të aplikohet në periudhën kur aktivit realizohet ose detyrimi të shlyhet bazuar në normat tatimore që janë në fuqi ose që konsiderohet si i miratuar në datën e bilancit. Aktivët dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen kur ka të drejtë ligjore për të vendosur aktivet tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore dhe kur tatimi mbi të ardhurat i lidhur me këto mbledhet nga i njëjti organ tatimor.

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **3.13. Garancitë financiare dhe angazhimet për hua**

Në rrjedhën e zakonshme të biznesit të saj, Banka ka hyrë në angazhime jashtë bilancit të tilla si garancitë, angazhimet për të dhënë kredi dhe letrat e kreditit dhe transaksione me instrumente financiare.

Kontratat e garancisë financiare janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar nuk bën pagesat në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Garanci të tilla financiare i jepen bankave, institucioneve financiare dhe organeve të tjera në emër të klientëve për të siguruar kredi, mbitërheqje dhe produkte të tjera bankare.

Garancitë financiare në datën e lëshimit njihen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e tarifës së pranuar. Tarifa amortizohet në fitim dhe humbje gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e Bankës nga garancitë me pastaj maten si vlera më e madhe nga: matja fillestare, zvogëluar me amortizimin e llogaritur për të njohur të ardhurat nga tarifat gjatë periudhës së garancisë; ose vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

**Garanci për përfundimin** - janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që pëson për shkak se një debitor i caktuar dështon që të përfundojë punën në kohe, në përputhje me kushtet e kontratës.

Garancitë në datën e lëshimit njihen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e tarifës së pranuar. Tarifa amortizohet në fitim dhe humbje gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e Bankës nga garancitë maten si vlera më e madhe nga:

- Matja fillestare, pakësuar për amortizimin e llogaritur për të njohur të ardhurat nga tarifa gjatë periudhës së garancisë; ose
- Vlerësimi më i mirë i shpenzimit të kërkuar për të shlyer detyrimin.

#### **3.14. Provizionet**

Nje provizion njihet kur Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që flukse të mirash ekonomike që do të kërkojnë për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim të besueshëm i shumës së detyrimit mund të bëhet. Provizionet maten me vlerësimin më të mirë të menaxhmentit për shpenzimin e kërkuar për të shlyer detyrimin në datën e bilancit dhe skontojnë në vlerën e tashme kur efekti është material.

#### **3.15. Përfitimet e punonjësve**

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për planin e pensioneve të administruar në mënyrë publike. Banka nuk ka detyime të tjera pas pagesës së këtyre kontributeve. Kontributet janë regjistruar si shpenzime të përfitimëve për punonjësit në momentin e duhur.

#### **3.16. Qirate operative**

Pagesat e bëra për qiranë operative i ngarkohen shpenzimeve në bazë të metodës lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë. Kur një qira operative përfundon para se periudha e qirasë të ketë skaduar, çdo pagesë që kërkojnë të bëhet qiradhënësit si ndëshkim njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën ndërprerja ndodh.

**3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)****Standardet e lëshuara ende të pa adoptuara**

Një numër i standardeve të reja dhe ndryshimet në standarde janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2015 dhe aplikimi i hershem është i lejuar; megjithatë, Banka nuk ka filluar zbatimin me heret për standardet e mëposhtme të reja ose standardet e ndryshuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standardet e reja në vijim dhe interpretimet që hyjnë në fuqi për Bankën nga 1 janar 2015:

| Standardet e reja ose te ndryshuara                               | Permbledhje e kërkesave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Efekti i mundshëm ne paqyrat Financiare                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| SNRF 9<br><i>Instrumentat Financiar</i>                           | SNRF 9, i publikuar në korrik të vitit 2014, zëvendëson udhëzimet ekzistuese në SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin udhëzime të rishikuara mbi klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë edhe një model të ri të pritshëm të humbjes së kreditit për llogaritjen zhvlerësimit të aktiveve financiare, dhe kërkesave të reja të kontabilitetit të përgjithshëm mbrojtës. Ai gjithashtu ka cuar përpara udhëzimet mbi njohjen dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare nga SNK 39. SNRF 9 është efektive për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit të vitit 2018, dhe aplikimi i hershem është i lejuar. | Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rrjedhin nga zbatimi i SNRF 9.<br><br>Duke pasur parasysh natyrën e operacioneve të Bankës, ky standard pritet të ketë një ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të Bankës. Në veçanti, llogaritja e zhvlerësimit të instrumenteve financiare në baza të pritshme të humbjeve të kredisë pritet të rezultojë në një rritje në nivelin e përgjithshëm të lejimeve për zhvlerësimet. |
| <i>SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me klientët</i>                 | SNRF 15 përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat njihen. Ajo zëvendëson standardin udhëzues ekzistues për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat e ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet konsumatorët lojal.<br><br>SNRF 15 është në fuqi për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me miratimin e hershëm të lejuar.                                                                                                                                                                                                                                                         | The Bank is assessing the potential impact on its financial statements resulting from application of IFRS 15.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Bujqësia:<br>Fabrika bartëse<br>(Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41) | Këto ndryshime kërkojnë një fabrikë bartëse, përcaktuar si një fabrikë të gjallë, që të kontabilizohet si pronë, impiantet dhe pajisjet dhe përfshirë në fushën e SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale, në vend të SNK 41 Bujqësia.<br>Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore raportuese që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershëm të lejuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Asnjë.<br>Banka nuk ka ndonjë fabrikë bartëse.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |

### **3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

#### **Standardet e lëshuara ende të pa adoptuara (vazhdim)**

Standardet në vijim të reja ose të ndryshuara nuk pritet të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës.

- IFRS 14 shyrja e llogarive rregullative.
- Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta (Ndryshimet në SNRF 11).
- Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimi dhe Amortizimi (ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38).
- Metoda e Ekuitetit në pasqyrat financiare individuale (Ndryshimet në SNK 27).
- Shitja apo kontributi i Pasurive në mes të një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkët (Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28).
- Përmirësimet vjetore në SNRF 2012-2014 Cikli - standardet e ndryshme.
- Entitetet investuese: Aplikimi përjashtim për Konsolidim (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28).
- Iniciativa për shpalosje (Ndryshimet në SNK 1).

Përveç nëse ndryshe përcaktohet më sipër, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë dukshëm pasqyrat financiare të Bankës.

#### **4. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve**

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, drejtimi ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacion në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 28.



**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

**5. Paraja e gatshme dhe balancat me bankat**

|                                                | <b>31 dhjetor 2015</b> | <b>31 dhjetor 2014</b> |
|------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Paraja e gatshme                               | 16,621                 | 13,837                 |
| Llogaritë rrjedhëse me bankat                  | 5,246                  | 3,910                  |
| Depozitat                                      | -                      | 3,459                  |
| <i>Shumat e mbajtura në BQK</i>                |                        |                        |
| Llogaritë rrjedhëse                            | 20,549                 | 17,885                 |
| Rezerva e detyrueshme                          | 30,460                 | 28,802                 |
| <b>Paraja e gatshme dhe balancat me bankat</b> | <b>72,876</b>          | <b>67,893</b>          |

**5.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj**

Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj ne pasqyrën e rrjedhës se parasë perbehet nga:

|                                                              | <b>31 dhjetor 2015</b> | <b>31 dhjetor 2014</b> |
|--------------------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Paraja e gatshme ne arke dhe ne banka                        | 21,867                 | 21,206                 |
| Balancat e pakufizuara me BQK                                | 20,549                 | 17,885                 |
| Kredite dhe huadhëniet me bankat me maturim me pak se 3 muaj | 5,004                  | -                      |
| <b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj</b>               | <b>47,420</b>          | <b>39,091</b>          |

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

**6. Kredi dhe paradhënie për klientët**

|                                                    | <b>31 dhjetor 2015</b> | <b>31 dhjetor 2014</b> |
|----------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Kreditë për klientët                               | 265,005                | 233,467                |
| Mbitërheqjet                                       | 41,406                 | 46,595                 |
| Kartat e kreditit                                  | 33,804                 | 32,359                 |
|                                                    | <b>340,215</b>         | <b>312,421</b>         |
| Fondi i zhvlerësimit për humbjet nga kreditë       | (26,471)               | (25,396)               |
| <b>Totali kredive dhe paradhënies për klientët</b> | <b>313,744</b>         | <b>287,025</b>         |

Mbitërheqjet paraqesin produkte afatshkurtra përsëritëse dhe kredi konsumatore.

Më 31 dhjetor 2015 kredi dhe paradhënie për klientët përfshijnë te ardhurat nga interesi i perlogaritur prej 1,746 mijë EUR (2014: 1,991 mijë EUR) .

Lëvizja në provizionet për zhvlerësimet e kredive për klientët është si vijon:

|                                                            | <b>31 dhjetor 2015</b> | <b>31 dhjetor 2014</b> |
|------------------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Provizioni për zhvlerësimin e kredisë në 1 janar           | 25,396                 | 17,034                 |
| Ngarkimi i shpenzimit të zhvlerësimit gjatë vitit          | 1,099                  | 8,396                  |
| Kredi të fshira                                            | (24)                   | (34)                   |
| <b>Provizioni për zhvlerësimin e kredisë në 31 dhjetor</b> | <b>26,471</b>          | <b>25,396</b>          |

Ngarkimi i shpenzimit gjatë vitit i regjistruar në fitime dhe humbje është si vijon:

|                                                   | <b>31 dhjetor 2015</b> | <b>31 dhjetor 2014</b> |
|---------------------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Ngarkimi i shpenzimit të zhvlerësimit gjatë vitit | 1,099                  | 8,396                  |
| <b>Ndryshimi në fitim dhe humbje</b>              | <b>1,099</b>           | <b>8,396</b>           |

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

**6. Kredi dhe paradhënie për klientët (vazhdim)**

|                                                     | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|-----------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
| <b>Provizioni i ngarkuar per individet:</b>         | <b>7,013</b>    | <b>5,651</b>    |
| Kreditë për klientët                                | 3,930           | 3,032           |
| Mbitërheqjet                                        | 209             | 114             |
| Kartat e kreditit                                   | 2,874           | 2,505           |
| <b>Provizioni i ngarkuar per entitetet ligjore:</b> | <b>19,458</b>   | <b>19,745</b>   |
| Kreditë për klientët                                | 16,265          | 15,642          |
| Mbitërheqjet                                        | 2,896           | 3,827           |
| Kartat e kreditit                                   | 297             | 276             |
| <b>Totali</b>                                       | <b>26,471</b>   | <b>25,396</b>   |

Një analizë e industrise se portofolit bruto të kredive për personat juridik para provizioneve është si vijon:

|                         | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|-------------------------|-----------------|-----------------|
|                         | Ne %            | Ne %            |
| Tregetia me shumice     | 53%             | 55%             |
| Prodhim                 | 15%             | 15%             |
| Konsum                  | 11%             | 13%             |
| Shërbime                | 7%              | 5%              |
| Hotelet dhe restorantet | 5%              | 4%              |
| Bujqësi                 | 3%              | 2%              |
| Ndërtim                 | 7%              | 7%              |
|                         | <b>100%</b>     | <b>100%</b>     |

Më 31 dhjetor 2015, dhjetë kredimarrësit më të mëdhenj përbënin 6.68% (2014: 5.38%) të totalit të portofolit të kredisë.

Të përfshira në kreditë për klientët janë të zhvlerësuar individualisht kreditë për klientët me një balancë prej 24,144 mijë EUR, si në 31 dhjetor 2015 (2014: 22,908 mijë EUR).

**7. Humbje të tjera nga rënia në vlerë dhe provizione**

Ngarkesa e zhvlerësimit në fitim dhe humbje është detajuar si vijon:

|                                                     | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|-----------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
| Lirimi i provizionit për garancitë                  | 27              | 217             |
| Ngarkesa për provizionet për bonuse                 | (146)           | -               |
| Ngarkesa për provizionet për raste gjyqësore        | (102)           | -               |
| Ngarkuar për provizionet për pushimet e papërdorura | (5)             | -               |
| <b>Ngarkesa në fitime dhe humbje</b>                | <b>(226)</b>    | <b>217</b>      |

**TEB SH.A.****Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

**8. Aktivet financiare të vlefshme për shitje**

Aktive financiare të vlefshme për shitje prej 10,288 mijë EUR më 31 dhjetor 2015 (2014: 7,277 mijë EUR) përfaqësojnë bono thesari te qeverisë dhe obligacione nga Banka Qendrore e Kosovës. Bonot e thesarit të qeverisë kanë maturitet duke filluar nga 10 shkurt 2016 deri me 31 gusht 2020, dhe jep te ardhura qe variojne nga 0.03% në 5.15%.

**9. Aktive të tjera financiare**

|                                                                              | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|------------------------------------------------------------------------------|-----------------|-----------------|
|                                                                              |                 | -               |
| Tarifa te përllogaritura te mirëmbajtjes të llogarive dhe të kredi kartelave | 1,540           | 1,316           |
| Aktive të tjera financiare                                                   | 170             | 130             |
| Të arkëtueshme nga institucionet e tjera financiare                          | 210             | 123             |
| <b>Totali i aktiveve të tjera financiare</b>                                 | <b>1,920</b>    | <b>1,569</b>    |

**10. Aktive të tjera**

|                                          | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|------------------------------------------|-----------------|-----------------|
| Shpenzimet e parapaguara                 | 68              | 75              |
| Te arkëtueshme të tjera                  | 228             | 82              |
| Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje | 885             | 247             |
| <b>Totali i aktiveve tjera</b>           | <b>1,181</b>    | <b>404</b>      |

Aktivet e mbajtura per shitje perbehen nga pronat ku Banka e ka marrë titullin / pronësinë si permbushje ndaj borxheve të papaguara ndaj Bankës. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Banka kishte në posedim një shumë prej 885 mijë EUR dhe (2014: 247 mijë EUR).

Vlera e drejtë e këtyre aktiveve është e përcaktuar nga vlerësues të brendshëm të Bankës. Këto aktive më pas zbriten në varësi të lokacionit, mirëmbajtjes, moshës dhe gjendjes për të reflektuar vonesat në zgjidhjen e mundshme dhe gjatësinë e kohës qe Banka ka mbajtur aktivet.

**TEB SH.A.**

**Shënimet e pasqyrave financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

**11. Pronat dhe pajisjet**

|                           | <b>Toka</b>  | <b>Përmirësimet e objekteve me qira</b> | <b>Mobiljet dhe orenditë</b> | <b>Kompjuter dhe pajisje te lidhura</b> | <b>Veturat</b> | <b>Totali</b> |
|---------------------------|--------------|-----------------------------------------|------------------------------|-----------------------------------------|----------------|---------------|
